



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Klos

RAPORT

“Auditimi Financiar”

BASHKIA KLOS

Tiranë 2024

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			2-2
I		PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-8
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.		HYRJA	8-14
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	8 - 9
	2	Identifikimi i çështjes	9 - 9
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-10
	4	Përgjegjësitë e audituesve	10-10
	5	Kriteret e vlerësimit	10-12
	6	Standardet e auditimit	12-13
	7	Metodat e auditimit	13-14
	8	Dokumentimi i auditimit	14-14
III.		PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-70
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14-15
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	15-70
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	15-21
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	21-25
	2.2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	25-34
	2.2.4	Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre	34-41
	2.3	Vlerësimi Raportimit Financiar, hartimi i pasqyrave financiare	42-56
	2.4	Mbi administrimin e asetëve, procedurat e inventarizimit e regjistrimit, qirate	56-63
	2.5	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	63-70
	2.6	Të ndryshme, të dala gjatë auditimit	70-70
IV.		GJETJET DHE REKOMANDIMET	71-80

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Klosit është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 4 njësi administrative si vijon: njësia administrative Klos (qyteti), njësitë administrative Xibër, Gurrë, Suc.

Bujqësia dhe infrastruktura: Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar gjatë viteve të fundit. Infrastruktura e Bashkisë është përmisuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve të shumta ndërkufitare por emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, vecanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar.

Të dhëna të tjera: Një pjesë e mirë e sipërfaqes është zonë fushore që përbëhet nga lugina e Matit me kullota që variojnë nga 240 metra në 600 metra mbi nivelin e detit. Klosi është dhe mbetet një nyje që lidh Dibrën me Tiranën. Lëvizjet demografike të popullsisë drejt zonave urbane, karakteristike për rajonin e Dibrës, vihen re dhe në Klos. Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore. Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe industria e mineralit të kromit në minierat private të Cërujës.

Misioni i Bashkisë Klos është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Klos si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Klos si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, përperiudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Klos. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare të vitit 2023.
- mbi procedurat e transferimit dhe rregjistrimit të pronave të palujtshme bashkisë dhe menaxhimin e tyre.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku.

Vlerësimi i riskut të kontrollit;

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2023 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 7,538 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 754 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli).

Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 11 gjetje dhe ka dhënë 13 rekomandime, nga ku masa organizative me 7 gjetje dhe 7 rekomandime, 1 gjetje-rekomandim si efekt negativ në buxhet nga të ardhurat e munguara në vlerën 661,021 lekë, 3 gjetje dhe 3 rekomandime si detyrime për tu arkëtuar në fushën e të ardhurave nga taksat në vlerën 80,636,412 lekë dhe tarifatat në vlerën 2,200,000 lekë, si dhe nga qiradhënia në vlerën 3,883,032 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

Për vitin 2023 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Klos paraqitet në masën 68 %, nga 60,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 40,467 mijë lekë. ky realizim ka ardhura nga mos arkëtimi i detyrimeve debitorë nga :

- Taksat dhe tarifatat e biznesit të vogël dhe të madh të 274 subjekteve debitorë në shumën 41,574,936 lekë;

- Taksat dhe tarifatat e 2,875 familje debitorë në shumën 39,061,476 lekë;

- Tarifatat e autorizimeve për 4 subjekte që ushtrojnë aktivitet për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij në shumën 2,200,000 lekë.

- Qiradhënia e aseteve nga 13 subjekte private me detyrime kontraktore në vlerën 3,883,032 lekë.

▪ ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe rregjistrimin e aseteve***

- Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të aseteve rezulton se, janë 1209 pyje-kullota të transferuara në fazë përfundimtare dhe 395 prona të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Klos (Qendër) dhe 3 Njësive Administrative si Suç, Gurre dhe Xibër që janë në fazën e miratimit të listave fillestare. Meqenëse këto prona nuk janë transferuara në përfundimisht Bashkisë Klos nuk është kryer asnjë proces hipotekimi/certifikimi. Pra për këto prona nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit dhe nuk është kryer asnjë proces për transferimin e pronave nga faza fillestare, në atë paraprake dhe më pas në atë përfundimtare dhe miratimin e listave të inventarit me VKM. Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

- Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe dokumentacionit të aseteve, rezulton se në territorin e Bashkisë Klos ushtrojnë aktivitetin 23 subjekte private, në 21 raste për prodhim dhe nxjerrje krom dhe në 2 raste gur gëlqeror, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Klos. Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor, venddepozitim minerali apo sipërfaqe për ngritje ngrehinash etj, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Klos.

▪ ***Në procedurat e raportimit financiar dhe hartimin e pasqyrave financiare***

- Nga analiza e gjendjes në vlerë historik prej 48,492,510 lekë llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në mbyllje të vitit 2023 vlera prej 31,683,734 lekë që i përket 35 projekt-studimeve është e pa shpërndarë sipas aktiveve përkatëse të investuara dhe të kapitalizuara në vitet e mëparshme para vitit 2020. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël, por nuk ka inventar fizik.

- Gjendja e llogarië 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë në gjendjen e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 90,232,252 lekë janë përfshirë 15 fatura të papaguara në vlerën 89,311,973 lekë të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit (60-ditë) të vitit ushtrimor të mbyllur, të cilat duhet të ishin pjesë e gjendjes e llogarië 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasi klasifikohen si detyrime të prapambetura.

- Nga auditimi i gjithë procedurës së inventarizimit rezulton se, nuk ka përfunduar procedura e klasifikimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi në ato që mbetjet e tyre kanë akoma vlerë përdorimi dhe kthimi i tyre në magazinë si dhe ato mbetje që nuk kanë vlerë përdorimi e vazhdimi për asgjësimin e tyre.

- Gjithashtu është kryer inventarizimi fizik i AAGJM të përfshira gjendje në llogaritë: 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Ndërsa në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë rregjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet, kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Klos ***në lidhje me të ardhurat***, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore në vlerën **80,636,412 lekë** nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, familjarë, fermerë, individë etj, vlerën prej 2,200,000 lekë për tarifën e autorizim/licencën në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, vlerën prej **661,021 lekë** për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 25 objekte të legalizuara dhe vlerën prej 3,883,032 lekë të tarifës së qirasë nga qiramarrësit e aseteve në pronë/përdorim të Bashkisë.

- Në lidhje me ***inventarizimin, përditësimin dhe rregjistrimin e aseteve në ASHK*** Bashkia Klos nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 Njësive **Klos (Qendër) Klos, Suç dhe Gurre**, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave fillestare dhe më pas ato paraprake të pronave për të akluar në fazën përfundimtare dhe miratimi i transferimit të tyre me VKM në pronësi/përdorim Bashkisë Klos, duke hapur rrugë përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor në regjistrimin e tyre në ASHK.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinion i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Klos për vitin e ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmitë mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një ***opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes*** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Klos, të cilat rezultojnë në opinionin tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare, por ekzistojnë aspekte që duhen theksuar.

Baza për opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare-Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **7,538 mijë lekë**.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh, të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

-Vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 31,683,734 lekë projekt-studimeve është e pa shpërndarë sipas aktiveve përkatëse të investuara dhe të kapitalizuara në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël, por nuk ka inventar fizik.

- Gjendja e llogarië 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë në gjendjen e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 90,232,252 lekë janë përfshirë 15 fatura të papaguara në vlerën 89,311,973 lekë të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit (60-ditë) të vitit ushtrimor të mbyllur, të cilat duhet të ishin pjesë e gjendjes e llogarië 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasi klasifikohen si detyrime të prapambetura.

- Nga auditimi i gjithë procedurës së inventarizimit rezulton se, nuk ka përfunduar procedura e klasifikimit të aktiveve të nxjerra jashte perdorimi e vazhdimi për asgjesimin e tyre.

- Gjithashtu nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJM të përfshira gjendje në llogaritë: 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Ndërsa në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë rregjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet, kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 492/1, datë 15.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 16.04.2024 deri në datë 10.05.2024, në subjektin Bashkia Klos për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. K, përgjegjës grupi,
2. I. Sh., auditues;
3. F. Ç., auditues;
4. V. Sh., auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Klos.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Projekt Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Klos, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Klos.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Klos (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA, si dhe NZ janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Klos, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Klos dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Klos është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e

vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve

IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Mtodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudklosh. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohem nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normale”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e

² *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
 - Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve u përgatit Projektraporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Klos

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Klos u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të raportimit financiar, të menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, menaxhimit, inventarizimit dhe hipotekimit e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Bashkia Klos ndodhet në zonën Verilindore të Shqipërisë dhe është pjesë e Qarkut Dibër, së bashku me 3 bashki të tjera: Dibër, Mat dhe Bulqizë. Ajo kufizohet në Jugperëndim me Bashkinë e Tiranës, në Veriperëndim me Bashkinë e Matit, në Lindje me

Bashkinë e Bulqizës dhe në Verilindje me Bashkinë e Dibrës. Bashkia ka një sipërfaqe prej 377 km², sipërfaqja e tokës bujqësore është 7,897 ha, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga pyje, kullota, lëndina, kreshta, etj. Territori i bashkisë përshkohet nga lumi Mat Distanca më e shkurtër në rrugë nacionale me kryeqytetin është 110 km, 50 km larg nga pika e kufirit Bllatë me Maqedoninë, 44 km larg nga Nj.A. Suç, 36 km larg nga NJA Gurrë dhe 18 km larg nga NJA e Xibrit.

Popullsia: Popullsia e bashkisë sipas regjistrimit të bërë nga censusi i 2011 ishte rreth 16, 618 banorë, ndërsa sipas regjistrimit civil ishte 20, 821 banorë me një dendësi prej 78 banorë për km².

Historik i zhvillimit ekonomik: Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore. Me vendim të KM janë një sërë pasurish natyrore që janë shpallur monumente natyrore, monumente kulture dhe monumente historike. Në këtë zonë mund të përmendim disa monumente si: Rruga e vjetër e Arbrit, Ura e Allamanit, Ura e Vashës, Kalaja e Xibrit, Sarajet e Zogut, Varri i turkut, Kulla e Dedollit, etj. Ndërtimi gjeologjik dhe relievi. Aktualisht në Bashkinë Klos ushtrojnë aktivitetet rreth 200 subjekte private në fusha të tilla si: tregti, shërbime dhe nxjerrje minerali kromi. Sektori shëndetësor përfaqësohet me 20 qendra shëndetësore dhe 5 farmaci. Sektori arsimor përbëhet nga 3 shkolla të mesme dhe disa shkolla 9-vjeçare të shpërndara në njësitë e bashkisë. Ndër prioritetet kryesore për bashkinë është zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe blegtorisë, duke mos lënë pas dore promovimin e turizmit. Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe industria e mineralit të kromit në minierat private të Cërujës.

Sfidat me të cilat përballlet: Bashkia përballlet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit, rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave fiskale dhe menxhimit të mirë të resurseve që ka kjo bashki; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rendësia e këtij auditimi është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimit të auditimit

2.1 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundur dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

a) *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike;*

Titullari i njësive publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se “*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësive publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Klos nuk ka një Kod Etike të mirëfilltë, të trupëzuar në një dokument të veçantë, por si pjesë e rregullores të miratuar me Vendim të Kryetarit nr.130, datë 09.07.2020, përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Institucioni ka një komision etike për të trajtuar këto çështje, i ngritur me Urdhër nr. 32, datë 08.02.2023.

b) *Politikat menaxheriale dhe stili i punës;*

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxiti kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Bashkia Klos ka hartuar një strategji risku me nr.1488 prot., datë 13.06.2023 në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre.

Grupit të auditimit i është paraqitur urdhri i titullarit në të cilin përcakton ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, si organ i rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit

financiar të njësisë publike dhe në sistemin e kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit për MFK. Nga kjo rezulton se për vitin 2023 titullari i Bashkisë Klos ka nxjerrë Urdhrin me nr. 44, datë 17.02.2023 për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Urdhrin me nr. 52, datë 10.03.2023 për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Klos.

Me zgjedhjet për pushtetin vendor të zhvilluara dhe në këtë Bashki rezulton se nuk janë reflektuar ndryshimet emërore të ndodhura si në dokumentin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Bashkinë Klos për vitin 2023 dhe në Ekippet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, të ngritura me Urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr. 52, datë 10.03.2023

Këto ndryshime janë reflektuar në dokumentin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Bashkinë Klos për vitin 2024 me Nr. 18 (Nr.3557/3 prot.) datë 30.01.2024 dhe me Urdhërin e Kryetarit me Nr.47 (Nr.953 prot.) datë 26.03.2024 “Për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2025-2027”.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike”. Për sa më sipër, për vitin 2023, rezulton të jetë realizuar vetëm një mbledhje e GMS në të cilën është miratuar dokumenti i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Bashkinë Klos me nr.1488 prot. Datë 13.06.2023.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Bashkia Klos e kryen aktivitetin e saj në bazë të Rregullores së brendshme, e miratuar me Vendim Kryetari nr.130, datë 09.07.2020.

Për vitin 2023, Bashkia Klos ka funksionuar mbi bazën e kësaj Rregulloreje.

Bashkia Klos disponon përshkrime pune, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” në të cilin përcaktohet se “Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/ pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatës.

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Klos hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil konformë Ligjit nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Klos” për çdo vit ushtrimor.

Planet vjetore janë miratuar me vendimet e sipërcituara dhe janë hartuar mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë së Klos bëhet në faqen zyrtare të saj, konformë VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6.

Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore bazuar në planin vjetor, ndiqet procedura nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi, Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”,

VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, i ndryshuar pagat e punonjësve të Bashkisë Klos janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 21.12.2022, “Për miratimin e pagave të punonjësve të Bashkisë Klos për vitin 2023”:

Nga 50 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat:1 (një) pozicion i kategorisë së lartë; 3 (tre)pozicione të kategorisë së mesme drejtues; 12 (dymbëdhjetë) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe 34 (tridhjetë e katër) pozicione të kategorive ekzekutive rezultojnë 8 (tëtë) vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil.

Nga auditimi rezulton se vendet vakante në Bashkinë e Klos janë krijuar jo vetëm si rezultat i ristrukturimeve, por edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore për pozicione që kërkojnë një kualifikim të caktuar.

Nga auditimi konstatohet se, numri i personelit në Bashkinë Klos referuar strukturave organizative, ka ndryshuar nga viti 2022, duke qenë se sektori i ujësjellësit që ka qenë në varësi të Bashkisë Klos ka kaluar në Drejtori Rajonale Dibër dhe për pasojë numri i punonjësve është ulur me 26 punonjës.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017 nga ana e Bashkisë së Klos për vitin 2023 janë planifikuar pozicione me status “ekselent” në strukturën e organike. Kjo miratuar me Urdhërin nr.8, datë 19.01.2024 “Miratimi i Strukturës së Bashkisë Klos viti 2024”. Ky pozicion vazhdon të jetë i lirë.

ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” “Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit’. Gjithashtu, Bashkia Klos disponon një program trajnimi për punonjësit dhe janë dërguar nevojat për trajnim sipas shkresës nr.2703/1 prot., datë 07.11.2022, “Kthim përgjigje”.

Për vitin 2023 nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Klos është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

- Nuk është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për vitin 2023, për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm e për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese.

- Për periudhën 2023 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, i cili nuk ka kryer detyrat për vendosjen e rregullave të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Bashkia Klos ka hartuar një strategji risku, me shkresën nr.1488 prot., datë 13.06.2023.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim ka hartuar regjistër risku me nr.1488/1 prot., datë 30.06.2023.

Bashkia Klos nuk ka hartuar një strategji plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit dhe tolerancës së riskut, duke mos përcaktuar kështu nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Klos, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësive.

Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Klos për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

- Mungojnë procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

4. Informacioni dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Klos, është e qartë dhe e verifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, pasi kjo realizohet qoftë me anë të shkresave, takimeve, apo emaileve zyrtare që janë të hapura për çdo punonjës. Gjithashtu është e verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Klos ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen Ëeb Bashkia Klos ka programin e transparencës, në zbatim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku në nenin 4 përcaktohet se ‘*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni*’. Gjithashtu, Bashkia Klos ka edhe regjistrin me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në zbatim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se “*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër*”.

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

5. Monitorimi

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, përcaktohet se “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë”. Për sa më sipër, ka dokumentim të raportimit mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në zbatim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

- Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të MFK si dhe plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Klos ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit e cila i është dërguar Ministrisë së Financave (DHMFK) me shkresën nr.731/2 prot. Datë 28.02.2024.

Për vitin 2023 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Klos ka hartuar deklaratën sipas shkresës nr.731 prot., datë 28.02.2024 dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me shkresën nr.731/1 prot., datë 28.02.2024, të cilat i ka nisur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8, pika 8, germa “b”, neni 27, pikat 1-2, neni 16, pika 2-3, neni 21, pika 2; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3; Rregullorja e Brendshme neni 16 “GMS”.

Per sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. I. H. në funksionin e ish/Kryetarit të Bashkisë Klos dhe zj.V. K. në funksionin e Kryetares aktuale të Bashkisë Klos.

2.1.2 Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm;

2.1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm

▪ Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm.

Struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Klos është miratuar me urdhër të kryetarit të Bashkisë me nr.17 prot datë 05.02.2020 me përbërje, sipas structures, 1 përgjegjës dhe 2 inspektorë.

Për vitin 2023 Sektori i Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 përgjegjës dhe 2 inspektor. Sektori i Auditit të Brendshëm është e organizuar si Njësi në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë. Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Periudha 2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	V. M.	P/ Sek.A.B	Ekonomist	30	4	PO	PO
2	M. D.	Sp.Auditi	Ekonomiste	28	4	PO	PO
3	Xh. B.	Sp.Auditi	Ekonomiste	8	4	PO	PO

Për periudhën Janar - Dhjetor 2023, Sektori ka funksionuar me 2 specialist, dhe përgjegjësën e sektorit. Punonjësit e sektorit të AB janë të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, në pëputhje me Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” .

Në lidhje veprimtarinë e vitit 2022 të kësaj NJAB është ushtruar auditim i jashtëm si nga KLSH ashtu dhe nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Auditim i cili është ushtruar në bazë të Programit për vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Klos me nr. 4806/4 prot. Datë 09.10.2023. për periudhën e aktivitetit viti 2021 dhe viti 2022.Në perfundim të të cilit është dërguar Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë me shkresën nr.4806/7 prot. Datë 07.12.2023 (Protokolluar në Bashkinë Klos me nr.3366 prot. Datë 12.12.2023). Në këtë Raport janë lënë dhe rekomandime për tu zbatuar nga Bashkia Klos gjë që do të mund të realizohen dhe duhet të realizohen në veprimtarinë e NJAB përgjatë vitit 2024. Përgjegjësi për gjendjen bie mbi drejtuesin e Njesisë së AB të bashkisë Klos

▪ **Karta e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik.**

NJAB në mbështetje te Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik” në Bashkinë Klos. Nga ana e Bashkisë Klos është hartuar e miratuar Karta e Auditimit të Brendshëm me Urdhërin e Kryetarit nr.1523 datë 15.06.2021.

▪ **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Ne mbështetje te Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik rezulton se janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Gjatë vitit 2023 me shkresën nr.2811, datë 18.10.2023 është miratuar plani strategjik për vitet 2024 – 2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024.

Plani Strategjik për periudhën 2024 – 2026, përbëhet nga:

Pasqyra Nr .1- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2024-2026.

Pasqyra Nr.2 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2024-2026.

Pasqyra Nr.3- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2024.

Pasqyra Nr.4 – Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2024.

Pasqyra Nr.5 – Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2024.

Në planin vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar në vitin 2024, gjithsej, në 9 fusha nga të cilat: Auditime Përputhshmërie 7 dhe Auditime të Kombinuara 2.

Në pëputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, këto plane janë dërguar zyrtarisht

(por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

▪ **Njësia e AB në Bashkinë Klos mbulon me auditim subjektet si më poshtë:**

- 1.Sektori i Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve
- 2.Sektori Çështjeve Juridike Prokurime dhe Burimet Njerëzore
- 3.Sektori i IT me median Arkiv Protokollit
- 4.Sektori i Financës
- 5.Sektori i të Ardhurave Pronave Publike, Leje dhe Licencave
- 6.Sektori i Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike, Barazisë Gjinore dhe Drejtave të Njeriut
- 7.Sektori i Turizmit, Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sportit, Policia Bashkiake
- 8.Sektori i Këshillit dhe Shërbimit Bujqësor, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Shërbimeve
- 9.Sektori Shërbimeve Menaxhimit të Mjeteve
- 10.Sektori i Ujitjes e Kullimit
- 11.Njësia e Koordinimit të IE dhe Ndhmës së Huaj
- 12.Sektori i Rrugëve Rurale
- 13.Inspektorati Mbrojtjes së Territorit , Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Gjithashtu njësia e AB në Bashkinë Klos mbulon me auditim edhe 4 njësitë Administrative të cilat janë:

1. Njësia Administrative Gurrë.
2. Njësia Administrative Suç.
3. Njësia Administrative Xibërr.
4. Njësia Administrative Klos.

▪ **Realizimi i Planeve Vjetore të Auditimit:**

Sipas planifikimit të vitit 2023, në Planin Vjetor të Auditimeve të miratuar me shkresën nr.2687 datë 18.10.2022 ka qenë parashikuar që nga Njësia e AB në Bashkinë Klos të mbulohen me auditim 7 subjekte si më poshtë:

- 1.Inspektorati Vendor Mbrojtjes së Territorit
- 2.Njësia Administrative Xibër
3. Njësia Administrative Klos
- 4.Sektori i Financës
- 5.Sektori i Çështjeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore
- 6.Sektori i të Ardhurave dhe Pronës Publike
- 7.Sektori i Ujësjes Kanalizimeve

Nga auditimi rezulton se nga NJAB janë zhvilluar e përfunduar gjatë vitit 2023 5 (pesë) misione auditimi si më poshtë:

- 1.Inspektorati Vendor Mbrojtjes së Territorit
- 2.Njësia Administrative Xibër
- 3.Njësia Administrative Klos
- 4.Sektori i të Ardhurave dhe Pronës Publike, Lejeve dhe Liçensave
- 5.Sektori i IT, Marrdhënies me Median e Publikun, Arkiv – Protokollit

Sektori i Auditit të Brendshëm ka kryer 5 misione auditimi kundrejt 7 misionesh të programuara ose 71.5 % e planit vjetor.

Nga plani vjetor i miratuar ka mbetur pa u realizuar auditimi në Sektorin e Çështjeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Sektorin e Financës, auditime të cilat rezulton se janë planifikuar për tu realizuar gjatë vitit 2024.

Ndërsa Sektorin e Ujësjes Kanalizimeve i planifikuar për auditim nuk është realizuar për arsye se nga 1 Janari 2023 nuk është më në varësi funksionale dhe administrative të Bashkisë

Klos, në vend të këtij misioni auditimi me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë është realizuar misioni i auditimit në Sektorin e të Ardhurave dhe Pronës Publike, Lejeve dhe Liçensave.

▪ **Veprimtaria e Njësisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2023.**

Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Klos për periudhën objekt auditimi, është raportuar duke u hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportin vjetor të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.531/1 prot, datë 13.02.2024 “Dërgim Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB”. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
1	Viti 2023	7	5	6	1			

Angazhimet e auditimit të llojit të përputhshmërisë janë realizuar në 5 subjekte: Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Njësië Administrative Xibër, Klos, sektori i IT, Mardhënive me median, arkiv-protokollit, Sektorin e të Ardhurave, Pronave publike, lejeve dhe licencave.

Në lidhje me Gjetje-Rekomandimet e konstatuara nga NJAB rezulton se:

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku **për vitin 2023** janë evidentuar 19 gjetje, për të cilat janë dhënë 19 rekomandime të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2023	19	11	6	2				
TOTALI		19	11	6	2				

Nga auditimi rezulton se, nga NJAB në lidhje me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për periudhën audituese nuk janë dërguar shkresa njësisive të audituara për të kërkuar informacion mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Të dhënat e realizimit të tyre nuk janë marrë në rrugë shkresore apo të jetë realizuar një mision auditimi në lidhje me to. Është e domosdoshme që nga drejtuesi i NJAB çështja e zbatimit të rekomandimeve duhet të trajtohet si çështje e rëndësishme që është detyrim ligjor për tu përmbushur konform nenin 6 “Roli i Auditit të Brendshëm“ të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin në Sektorin Publik”.

Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

N r	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2023	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1	Insp. Vend. i Mbr. së Territorit	3	3	3	2	1					3
2	Njësia Administrative Xibër	3	3	3	2	1					3
3	Njësia Administrative Klos	4	4	4	3	1					4
4	Sek. i IT, Mardh. me median Arkiv Protokollit	3	3	3	2	1					3
5	Sek. të Ardh. , Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave	6	6	6	4	2					6
	Totali	19	19	19	13	6					19

Ajo që konstatohet nga auditimi është fakti që dosjet e misionëve të auditimit të përfunduara nga kjo NJAB janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi i PBA 2023-2025 dhe programimi i buxhetit vjetor.

2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit , analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;(faturat e palikujduara të shoqërohen me listë, të detajuara me numër fatue dhe datë krijimi etj, raporti I tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e lokimit të granteve të FZSH dhe Ministrive të linjës etj.

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumenti i hartimit të PBA 2023-2025 dhe miratimi i tij dhe gjithë korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2023 të miratuara me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Mat shpenzimet dhe të ardhurat.

4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.

6. Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet te ardhurat etj.).

➤ **Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore.**

- Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr. 19 datë 31.01.2022, “Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik për vitin 2022”.

Urdhër i Brendshëm nr. 52, datë 31.03.2022, “Ngritjen e EMP për hartimin e Buxhetit 3-vjeçar për vitin 2023-2025” Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxheti i vitit 2023, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, i cili është miratuar me VKB nr.56 datë 24.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 5/1 prot., datë 07.01.2022 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1.

- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA me VKB nr.16, datë 28.03.2022 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 282/1, datë 05.04.2022 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 34/6.

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

- Në këtë programim është përfshirë Instrumenti të planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është dërguar në MFE me shkresën nr.prot.1405 prot., datë 31.05.2022 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarija e konomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2023-2024-2025.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e planifikimit urban. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollat përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2023-2025 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Klos në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesa publike.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

- **Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023**

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 82, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1344/1 date 04.01.2023, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	60 000	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	166 388	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	73 071	
4	Paga (600)		134 996
5	Sigurime shoqërore (601)		22 005
6	Shpenzime operative (602)		48 744
7	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		13 781
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		79 933
Totali i buxhetit		299 459	299 459

Me Vendim të KB nr.10, datë 27.02.2023 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.287/1, datë 07.03.2023, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Diferencë nga transferta e pakushtëzuar	25 497	
2	Grant i pashperndare(detyrimet e prapambetura)	0	
3	Të ardhurta të trashëguara	16 414	
4	Të çelura të papërdorura		
5	Grant i trashëguar		
6	Transferte e pakushteuar sektoriale e paperdorur	9 028	
8	Paga (600)		3 681
9	Sigurime shoqërore (601)		0
10	Shpenzime operative (602)		5 250
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		11 051
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		
13	Investime ne proces		30 957
Totali i buxhetit		50 939	50 939

Sipas tabelës së mësipërme buxhetii vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 299,459 mijë lekë dhe trashëgimet e fondeve në vlerën 50, 939 mijë lekë.

- **Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:**

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan fillestar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhurat e grant i pakush e spec)	157,001	160,409	-3,408
2	Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	62,025	56,706	5,319
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	80,433	79,804	629
4	Investime nga FZHSH			
Total I planit fillestar		299,459	296,919	2,540

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2023 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2023-2025, rezulton se ka diferencë prej 2,540 mijë lekë mbi tavanin e përcaktuar në PBA. Diferenca prej 2,540 mijë lekë e rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA (2023) i përket shpenzimeve në llogarive të 600 dhe 601, që është vlera e shtuar nga akordimi i fondit të transfertes sektoriale për financimin e shtesës së pagave për funksionet e kaluara në varësi në Bashkisë. Këto fonde janë planifikuar në mënyrë të përafërt, pasi nuk dihej transferta. Gjithashtu lidhur me pagat planifikimi është më i ulët në PBA 2023-2025, sepse në buxhetin e vitit 2023 nuk janë planifikuar paga për sektorin e ujësjellësit duke qene se ujësjellësi ka kaluar si drejtori Rajonale. Gjithashtu edhe ndryshimi përsa I përket shpenzimeve operative është për arsye të rritjes së transfertës së pakushtëzuar të vitit 2023, krahasuar me transfertën që ka ardhur sipas shkresës për PBA.

➤ 2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit , analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mat dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Klos dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Klos.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2023 paraqiten në Aneks.

Konkluzion: Nga sa më sipër konstatohet se, për vitin 2023 kanë ndodhur 2 ndryshime me VKB dhe 2 shtesa në buxhet me akte normative dhe VKM, 3 vendime të Këshillit të Qarkut Dibër, që kanë reflektuar shtesa në buxhet dhe VKB për përdorimin e fondit rezervë, të cilat tregojnë për planifikime optimiste, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

➤ *Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.*

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mat, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2023, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. nga auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Klos u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Në 000/lekë		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	155 412	141220	91
2	Sigurime shoqërore 601	23 399	23073	99
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë +606 transfert individ	102,288	73302	72
4	Nd/Ekonom invalid 606	290 824	276416	95
5	Investime (230/231)	246 486	121665	49
6	Mjete ne ruajtje 466		1008	
7	Bonus geraje pastrehet	17 952	17595	98
8	Fond i emergjencave civile min 17 (604)	2 958	54	1.8
	Totali	839 319	654 333	78

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2023** janë realizuar 654, 333 mijë lekë nga 839, 319 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 78%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar realizimi në masë të konsiderueshme në zërat e buxhetit:

- Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 72%, gjë që tregon se planifikimi është bërë më rezervë dhe shkaqet e mosrealizimit sipa institucionit janë në lidhje me mosrealizimin e të ardhurave, mosrealizmi i procedurave të prokurimit etj.
- Shpenzimet për investime llog.231 nga buxheti i Bashkisë, si dhe transfertat e kushtëzuar janë realizuar në masën 49%. Ky zë rezultoi i realizuar në nivel të ulët për arsye të mosrealizimit të punimeve për investime, kryesisht ato të financuara me fondet e akorduara nga Ministritë e linjës, si dhe në 1 rast të investimit të planifikuar me financim nga të ardhurat e veta, por në fakt është likuajtur me shtesat e buxhetit për detyrimet e prapambetura, duke lënë pa përdorur fondet e akumuluar nga të ardhurat e veta për këtë investim.

Konkluzion: Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2023 është në total në shumën 13 039 mijë lekë ose në masën 3%, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar i vitit buxhetor me VKB nr.82, datë.21.12.2022 dhe konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Dibër dhe nga VKB nr.10, date 27.02.2023 dhe është përdorur kryesisht për shpenzime operative dhe investime sipas vendimeve të KB. Përdorimi i Fondit Rezervë në vlerën 4 655 mijë lekë, sipas vendimeve të KB përkatëse:

-VKB nr.3 dt.24.01.2023/konf.105/1 dt.30.01.2023 “Për disa ndryshime buxheti i 2023”

-VKB nr.22 dt.27.03.2023/konf.406/1, dt.05.04.2023 “Për një ndryshim në buxhetin e 2023”

- VKB nr.25 dt.25.04.2023/konf.498/1 dt.04.05.2023“Për disa ndryshime buxheti i 2023”
- VKB nr.32 dt.29.05.2023/konf.586/1 dt.05.06.2023“Për disa ndryshime buxheti i 2023”
- VKB nr.58 dt.03.10.2023/konf.1025/1dt.12.10.2023“Për disa ndryshime buxheti i 2023”
- VKBnr.70 dt.30.11.2023/konf.1176/1 dt.01.12.2023“Për disa ndryshime buxheti i 2023”

- Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2023, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6. Për vitin 2023 është dërguar “Raport monitorimi Buxhetit Janar-Prill” me shkresën nr.prot.1332, date.18.05.2023, “Raport monitorimi Buxhetit Janar-Gusht” me shkresën nr.2645 prot, date.26.09.2023,“Raport monitorimi Buxhetit Janar-Dhjetor” me shkresën nr.726 prot, date 28.02.2024.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

- Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2023, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës apo FZSHH, AKUM, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog. 230-231
Viti 2023	23,869,856	23,869,856	81date 22.12.2022/ 10 datë 27.02.2023	23,869,856

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2023:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2022 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2023 - 31.12.2023 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve 2023 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZSHH	11,146,662	2,192,620	13,339,282	2,192,620	11,146,662
b. Investime nga Bashkia	23,869,856	123,673,554	147,543,410	69,998,159	77,545,251
INVESTIME:					
Mallra dhe shërbime	0	0	0	0	0
Rindertimi	0	0	0	0	0
Totali:	35,016,518	125,866,174	160,882,692	72,190,779	88,691,913

Referuar shkresës nr.prot.552/1 prot, datë.17.02.2023 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” të Bashkisë Klos dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 35,016,518 lekë dhenë fund të vitit 2023 referuar shkresës nr.prot.726 prot., datë 28.02.2024 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” në shumën 77,545,251 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar 125,866,174 lekë, por njëkohësisht është likujduar vlera prej 72,190,779 lekë, dhe vlera e mbetur e detyrimit është 88,691,913 lekë.

Konkluzion: Detyrimet e raportuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2023 me shkresën nr.726 prot datë 28.02.2024 janë në vlerën 77,545,251 lekë, nga e cila vlera e pa likujduar prej 59,133,339 është detyrim i mbetur për investimin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Pleshe-Ceruje-Patin”, i cili është realizuar si punime brenda vitit 2022 me financim nga të ardhurat e veta dhe transferta e pa kushtëzuar është programuar me shtrirje në tre vite 2022-2023-2024. Ndërsa vlera 11,146,662 lekë janë detyrime nga Ministrinë e Linjës, të cilat nuk janë përfshirë në raportim, pasi likujdimi i tyre është i varuar nga alokimi i fondeve nga Pushteti Qendror.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2023 janë të palikujduara gjithsej 16 fatura me vlerë 55,803,024. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Emertimi	Nr.Fature	Date Fature	Gjendje me dt. 31.12.2022	Likuiduar	Shtesa	Gjendje me dt.31.12.2023
Financimi nga FSHZH						11,146,662
Sist.asfaltim rruga Dars	375	02.06.2013	2,693,694			2,693,694
Sist.asfaltim rruga Dars	489	18.07.2015	5,968,453			5,968,453
Rik.shkolla Gurr e Vogel	19	29.05.2014	1,000,000			1,000,000
Rikonst.shkoll mesme Shaban Çollaku Klos	46	27.04.2020	1,484,515			1,484,515
Financ nga të ardhurat e tranferta e pakushtez						77,545,251
Sistemim asfaltim rruga Pleshe-Ceruje-Patin	95/2022	31.12.2022	0	63,506,931	122,640,270	59,133,339
Mbikq Sistem asfalt ne lagjet e qytetit Klos			78,240	78,240		0
Kolaud.Rikonst.shkoll mesme Sh. Çollaku Klos	16	27.04.2020	102,000			102,000
Rikonstruks.shkollle mesme Shaban Çollaku Klos	46	27.04.2020	7,447,003			7,447,003
Ndertim Muzeu Historik-Kulturor	8/2021	03.09.2021	1,001,255	926,598		74,657
Ndertim Muzeu Historik-Kulturor	27/2021	27.09.2021	9,611,169	1,601,862		8,009,307
Krijimi I tabelave inf. pikat turistike (BE)	29/2021	30.09.2021	717,600	119,600		598,000
Vendosja e shenjave per hiking (BE)	15/2021	27.09.2021	1,153,920	192,320		961,600
Mbik. Ndertim Muzeu Historik-Kulturor	17/2021	29.09.2021	223,273	37,212		223,273
Sist-asfalt. rrug Pleshe-Ceruje e rrug Ceruje-Patin	55/2022	06.09.2022	3,535,396	3,535,396		0
Rrethim varrezash	195/2023	13.07.2023			449,460	449,460
TVSH per park inovativ rekreacioni	14/2023	25.10.2023			583,824	583,824
Totali			35,016,518	69,998,159	123,673,554	88,691,913

Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2023 rezultoi se, është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit”. Detyrimet e prapambetura për vitin 2023 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.726 prot datë 28.02.2024 jepen në tabelën si më poshtë:

N.R	Emertimi	Stokunë vlerë	Totali i shpenzimeve Faktike per vitin 2023 pa fondet e kushtezuara	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua afatgjatë			

N.R	Emërtimi	Stokunë vlerë	Totali i shpenzimeve Faktike per vitin 2023 pa fondet e kushtezuara	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
a,1	Marrëveshje financimi			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër			
b,1	Marrëveshje financimi			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	77,545,251		26.71%
Llog. ekon				
4864100	Vendime gjyqësore			
4864200	Detyrime të prapambetura për shërbime			
4864201	D.P. energji elektrike			
4864300	D.P. mirëmbajtje			
4864400	D.P. investime	77,545,251		
4864500	D.P. rimbursim TVSh			
4864600	Mallra			
4864900	D.P. të tjera			
4864601	D.P. sigurime shoqërore			
4864602	D.P. sigurime shëndetësore			
4864603	D.P. ardhura personale			
4864604	D.P. tatime			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Transferta individuale			
4864904	Transferta subjektet			
III	Totali (I+II)	77,545,251	290,242,495	26.71%

Analiza e vlerës së e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2023 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

a. Me financim nga Bashkia Klos

Fatura të pa likuajuara 77,545,251 lekë, nga e cila vlera prej 59,133,339 është detyrim nga një investim “Sistemim asfaltim rruga Pleshe-Ceruje-Patin”, me vlerë totale 150,079,314 lekë i cili është realizuar me financim me shtrirje në tre vite 2022-2023-2024, dhe në kontratën nr.1360 prot., datë 26.05.2022 vlera 59,133,339 lekë është e parashikuar për t’u likuajuar për vitin 2024.

b. Me financim nga Ministrinë e linjës

Emertimi	Nr.F atur e	Date Fature	Gjendje me 31.12.2022	Likuiduar	Shtesa	Gjendje me dt.31.12.2023
Sist.asfaltim rruga Dars	375	02.06.2013	2,693,694			2,693,694
Sist.asfaltim rruga Dars	489	18.07.2015	5,968,453			5,968,453
Rik.shkolla Gurr e Vogel	19	29.05.2014	1,000,000			1,000,000
Rikonst.shkoll mesme Shaban Çollak Klos	46	27.04.2020	1,484,515			1,484,515
Totali						11,146,662

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2023 Bashkia Klos ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 88,691,913 lekë. Shuma prej 11,146,662 lekë fatura të pa likuajuara, për arsye se fondet për financimin e tyre nuk janë çelur nga FSHSH, fonde të cilat është ndërprerë alokimi i tyre që në vitin 2013. Krijimi dhe akumulimi idetyrimeve të papaguara në fund të vitit ushtrimor është në papajtueshmëri me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të

zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 88,691 mijë lekë, e përbërë nga vlera prej 77,545,251 lekë e faturave të papaguara me financim nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar e raportuar në MFE dhe vlera prej 11,146,662 lekë e faturave të pa likuiduara me financim nga Ministritë e linjës, për të cilat është ndërprerë alokimi i fondeve që nga viti 2013. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të pa paguara të Bashkisë Klos janë 26.7 % të shpenzimeve vjetore faktike prej 290,243 mijë lekë me burim financimi transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta. Në këto kushte Bashkia Klos konsiderohet në “vështirësi financiare”, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura tejkalon nivelin prej 25% të shpenzimeve vjetore faktike, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55, 56 dhe Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33, (Tabela 1) Rastet sipas gjendjes financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe pikat 86-123.

- Celja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar, ardhurat e veta të Bashkisë Klos, si dhe transferta të kushtëzuara.

- Për **vitin 2023** janë planifikuar fonde për investime në shumën **246,486,191 lekë** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura+transferte e kushtëzuar), realizuar dhe likuiduar në vitin 2023 në vlerën 121,665,127 lekë. Realizimi në masën 49.36 % i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si: nuk është prerë faturë nga operatori fitues, nuk janë realizuar të ardhurat. Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shpesh dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast. Projektet e investimit me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në Aneks. Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti.

Nga auditimi i procedurave të ndjekura në vitin 2023 për realizimin dhe financimin e investimeve me fondet e veta Bashkia Klos ka programuar 19 projekte investimesh nga ku rezultoi se, janë realizuar procedurat e prokurimit dhe finalizuar me kontratë 11 projekte me vlerë 3,222,817, nga të cilat janë realizuar plotësisht punimet në 11 projekte, në 2 projekte punimet janë në vazhdim për vitin 2024, si dhe fondet për financimin e tyre janë trashëguar në buxhetin e këtij viti, ndërsa 6 projekte investimesh nuk janë prokuruar në vlerën 2,266,260 lekë. Projekte të pa prokuruar për vitin 2023:

1. Furnizim vendosje kondicionerësh në vlerën 300,000 lekë.
2. Printer e skaner për zyrat e Këshillit Bashkiak në vlerën 80,000 lekë
3. Paisje zyre për Këshillin Bashkiak në vlerën 45,000 lekë.
4. Furnizim-vendosje, sistem hidratimi për MZSH në vlerën 721,260 lekë.
5. Ndëtim-vendosje oxhaku në MZSH në vlerën 120,000 lekë.
6. Mobilim i Muzeut Etnografik në vlerën 1,000,000 lekë.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 13 projekteve të investimeve Bashkia Klos me financim nga fondet e veta, 3 projekteve, ku 1 nga Ministria e

Arsimit për rikostruksion shkolle, 1 investim nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ndertim ure beton-arme dhe 1 investim nga AKUM për sistemim kanale të ujrave të zeza , rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka konfirmin me nënshkrim elektronik, datën e depozitimit dhe të miratimit nga Dega e Thesarit Mat. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ në Degën e Thesarit Mat dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar urdhër-blerja, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit dhe elementet e tjera të procedurave të prokurimit dhe dokumentave financiare.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emertimi	000/lekë		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	155 412	141 220	91
	grant I kushtezuar	5 795	5 405	93
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale	138 028	132 900	96
	te ardhura	11 589	2 915	25
2	Sigurime shoqërore 601	23 399	23 073	99
	grant I kushtezuar	605	545	90
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	22 725	22 464	99
	te ardhura	69	64	93
3	Shpenz.operative 602+ F.rezerve	65 721	44 811	68
	grant I kushtezuar	344	177	51
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	56 162	40 083	71
	te ardhura	9 215	4,551	49
4	K.Qarkut Transferime 604	4 368	465	11
	grant I kushtezuar	2 958	54	1.8
	grant I pakushtezuar	610	411	67
	te ardhura	800	0	0
5	Nd ekonomike invalid 606 ,bonus stehimi ,ndihma financiare	343 933	322 092	94
	grant I kushtezuar	333 905	317 591	95
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	8 180	2 716	33
	te ardhura	1 848	1 785	97
6	Investime 230-231	246 486	121 665	49
	grant I kushtezuar	102 372	43 310	42
	grant I pakushtezuar + trasnsferta specifike	89 721	67 463	75
	te ardhura	54 393	10 892	20
	Totali Bashkia Klos	839 319	653 325	78
	Mjete në ruajtje		1 008	
	Total Bashkia Klos +466 mjete ne ruajtje	839 319	654 333	

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2023 në masën 2 %.
- Shpenzimet në artikullin 601 “ kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2023 në masën 0.02%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “ shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2023 në masën 10 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “ investime” për vitin 2023 në masën 8.9 %.

Konkluzion: Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2023** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 10,892 mijë lekë ose në masën 1.7 %, nga

transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 266,037 mijë lekë ose në masën 41 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 367,082 mijë lekë ose në masën 57.3% .

2.2.6 Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave, qiratë e aseteve, tokave, pyjeve kullotave etj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Klos për miratimin e paketave fiskale të vitit 2023;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë së Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos është miratuar me VKB-në nr. 79, datë 21.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Klos me shkresë nr. 1342/1 prot., datë 04.01.2023. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Klos për vitin 2023 paraqitet në Aneks.

në lekë

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
I	Të ardhura nga Tatimet			
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	1,000,000	81,369	81
2	Tatimi mbi te ardhurave personale	3,500,000	6,101,618	174
II	Të ardhura nga Taksat			
1	Taksa mbi B. Vogël	350,000	0	0
2	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	2,000,000	2,040,705	102
3	Taksa mbi token Bujqësore	1,500,000	558,625	37
4	Taksë mbi rregj. e Automjete	4,500,000	6,178,368	137
5	Taksa e ndikimin të nd. mbi infrastrukturën	2,500,000	3,889,580	156
6	Taksë Tabele	40,000	16,802	42
7	Taksë hoteli	20,000	0	0
8	Taksë Parkimi	250,000	100,000	4
9	Taksë për hapësira publike			0
10	Taksë mbi truallin	600,000	533,269	89
11	Taksë për shfrytëzimin e lëndëa drusore	3,000,000	2,005,200	67
12	Taksë reklame	150,000	227,950	152
III	Të ardhura nga Tarifave			
1	Tarifë Pastrimi	2,600,000	2,859,852	110
2	Tarifë e inf. arsimore	1,000,000	771,400	77
3	Tarifë leje transport.	1,200,000	620,492	51
4	Tarifë ndriçimi rrugor	220,000	344,370	157

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
5	Tarifë vendore për dhënie leje mjedisore	750,000	1,006,850	134
6	Tarifë e ujit vaditës	540,000	479,800	89
7	Tarifë vendore për lëshim vërtetimi	200,000	112,370	56
8	Tarifë vendore për certifikatën e përdorimit	200,000	21,000	11
9	Tarifë vendore për shqyrtime leje zhvillimi	100,000	0	0
10	Tarifë vendore për leje ndërtimi	500,000	38,000	8
11	Tarifë vendore për hidrocentralet ujore	600,000	0	0
12	Të ardhura nga i njëjti nivel qeverisje (Qarku)	0	1,500,000	0
IV	Të ardhura të tjera			
1	Të ardhura nga qera për troje, pyje dhe kullota	5,000,000	1,788,775	36
2	Të ardhura nga renta minerare	200,000	90,614	45
3	Të ardhura nga shfrytëzimi i nëntokës	2,950,000	3,838,100	130
4	Të ardhura nga qera për ndërtesa	100,000	58,200	58
5	Të tjera të ardhura nga ndërtesa dhe pronësia	1,800,000	0	0
6	Tarifë për shërbim social (kopshtet e fëmijëve)	1,250,000	922,460	74
7	Të ardhura nga gjoha	350,000	3000	9
8	Shitja e produkteve bujqësore dhe pyjore	200,000	0	0
9	Të ardhura nga kamatvonesa	250,000	215,788	86
10	Të ardhura nga sekuestrime dhe cdemtime		302,736	0
11	Të ardhura nga qeverite e huaja (grante)		3,723,000	0
	GJITHSEJ (I+II+IV)	60,000,000	40,466,683	68

Burimi: Bashkia Klos

Konkluzion: Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023 janë realizuar në masën 68% nga 60,000,000 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 40,466,683 lekë. Kjo masë e ulët realizimi të të ardhurave tregon se, nuk është bërë punë e mjaftueshme për vjeljen taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit, si dhe uljen e borxhit nëpërmjet punës në terren dhe masave shtrënguese, me qëllim rritjen e të ardhurave të bashkisë.

- **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Klos kryhet në programin Excel. Drejtoria e Financës dhe Taksave gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Tabela nr.II.6.2: Numri i bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Klos 2023

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	190	3	40	153
2	Biznesi Madh	57	9	16	50
	Gjithsej	247	12	56	203

Burimi: Bashkia Klos

- **Menaxhimi i borxhit**

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistratit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Klos, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj), i

cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2022** vlera progresive e debitorëve është **12,934,447 lekë** dhe në fund të **vitit 2023** vlera progresive e debitorëve është **80,636,412 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet si më poshtë: 56,874 mijë.

në lekë

Nr	LLOJI I DEBITOREVE	Periudha 2011 deri me 31.12.2023						Shuma e Detyrimeve 2023
		Lloji i Detyrimeve		Detyrime 2022	Sistemime	Shtesa	Pakësime	
1	Biznes i Vogël	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, Taksë ndërtese, Taksë table	8,844,811	38,667,987	6,412,164	3,505,215	41,574,936
2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, reklame, Taksë ndërtese, Taksë Tabele,					
3	Biznes ne lidhje me sektorin pyjor	Te ardhura nga kontrata	Qira fondi pyjor kullusor	0	0	0	0	0
4	Kryefamiljare, taksa pagues	Taksa dhe tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, Taksë ndërtese, Taksë trualli, takse dru zjarri, tarife e perkohshme	4,089,641	32,885,480	7,912,855	1,736,859	39,061,476
TOTALI				12,934,452	71,553,467	14,325,019	5,242,074	80,636,412

Burimi: Bashkia Klos

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Klos paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2023 është lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat e tarifatat biznesin e vogël e të madh janë në shumën 41,574,936 lekë.
- Detyrime nga taksa dhe tarifa për familjaret ne shumen 39,061,476 leke.

Gjendja e debitorëve progresiv të **vitit 2022** rezulton në vlerën **71,553,467** lekë, gjatë vitit 2023 janë paguar detyrime në total në vlerën 5,242,074 lekë, nga shtesat në vlerën 14,325,019 duke zbritur pagesat, rritja e debitorëve është në vlerën 9,082,945 lekë, kështu gjendja e debitorëve progresiv **në fund të vitit 2023** është në vlerën **80,636,412 lekë**.

- **Taksat dhe tarifatat familjare**

Në Bashkinë Klos aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit, taksa e tokës, taksën e ndërtesës, tarifa për dru zjarri, tarifa e ndriçim - gjelbërimit, taksa e truallit, tarife e perkohshme (infrastruktura arsimore).

Familjet në Bashkinë Klos ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndricimit dhe taksën e perkohshme të arsimit. Bashkia Klos për vitin 2023 ka **2,875 familje debitore**. Nga ana e sektorit janë ezauruar njoftimet për shlyerje detyrimesh, njohja me detyrimet. Bashkia Klos, Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna të sakta lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna të sakta lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna të sakta për numrin e familjeve, që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, Bashkia Klos për vitin 2023 nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si rezultat i mangësive dhe pasaktësisë së të dhënave për taksapaguesit familjarë dhe fermerë në periudhat e mëparshme, duhet të riformulojë regjistrat me të dhëna të përditësuar për të përcaktuar saktë planifikimin dhe pritshmërie e vjeljes së kësaj takse, në mënyrë që të rriten të ardhurat.

- **Taksa mbi tokën bujqësore**

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23³.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Klos klasifikohet në kategorinë e katërt, ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme:

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	
II	
III	
IV	1000
V	
VI	
VII-X	

Referuar VKB-në nr. 79, datë 21.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Klos me shkresë nr. 1342/1 prot., datë 04.01.2023. Toka bujqësore në Bashkinë Klos klasifikohet në kategorinë IV me detyrim 1000 lekë/ha/vit.

Planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës është 1,500,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 558,625 lekë, ose në masën 37%, pra në nivel shumë të ulët. Sipas të dhënave të paraqitura nga zyra e Kadastrës, të dhënat për Fondin i tokës, struktura dhe ndarjes së AMTP-ve, baza për planifikimin e taksës së tokës është 3880 ha x 1000 lekë/ha në vit rezulton 3,880,000 lekë dhe jo 1,500,000 lekë sa është planifikuar e ardhura në fakt nga taksa e tokës. Këto të dhëna paraqiten në tabelën mëposhtme:

Në ha

Nr	Njësia Administrative	Toke bujq. gjithsej	Nr. Fam. Që kanë marr AMTP	Sipërfaqja e tokës ndarë në fakte Ligji 7501	Kategoria e tokës ndarë sipas ligjit 7501/ në hektar					Sipërfaqja e ndarë sipas kategorive	Sipërfaqja e tokës së pandanë	Sip. e tokës dhënë me qira
		Ha ne 1991			III	IV	V	VI	VII			
1	Klos	2534	-	2015	-	-	1788	746	-	2015	519	-
2	Suç	868	-	609	-	180	266	422	-	609	259	-
3	Gurre	630	-	248	-	-	-	191	439	248	382	-
4	Xiber	1254	-	1008	-	393	861	-	-	1008	246	-
5												
6												
Shuma		5286	-	3880	-	573	2915	1359	439	3880	1406	-
		Çmimi sipas VKB me 1000 lekë/ha/vit								3,880,000		

Konkluzion: Në Bashkinë Klos familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 79, datë 21.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023 pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori

³Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 1.

i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 1000 lekë/ha/vit, kur bashkia ka të dhëna.

Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave rezultoi se, taksapaguesit familjarë në bazë të paketës fiskale të miratuar me VKB ngarkohen taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndricimit dhe taksën e përkohshme të arsimit, por nuk ka të dhëna të sakta lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar dhe nivelin e pritshmërisë së tyre, si dhe nuk ka të dhëna të sakta për numrin e familjeve, që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, Bashkia Klos për vitin 2023 nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme.

- **Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Klos është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.⁴

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar.

Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Sektori i Taksave me shkresën nr. 3348 prot, datë 11.12.2023 ka njoftuar 97 subjekte (biznes i vogël), me shkresën nr. 3347 prot, datë 11.12.2023, me shkresën nr. 3074 prot, date 13.11.2023 ka njoftuar subjektet që kanë hidrokarbure, me shkresën nr. 3348 prot, datë 11.12.2023 ka njoftuar 97 subjekte (biznes i vogël) dhe 32 subjekte (biznes i madh), me shkresë 2872 prot, datë 24.10.2023 janë njoftuar të gjithë punonjësit që janë të punësuar pranë Qendrës Shëndetësore Klos, me shkresën nr. 2873 prot, date 24.10.2023 njoftim për të gjithë punonjësit që punojnë tek Kopshti Klos, me shkresën nr.22871 prot, date 24.10.2023 njoftim për shlyerje të detyrimeve të punonjësve që punojnë pranë OSHE, me shkresën nr. 2885 prot, date 25.10.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh për punonjësit që punojnë pranë Masonerisë, me shkresën nr. 2869 prot, date 24.10.2023 njoftim për punonjësit e Arsimit, me shkresën nr. 2897 prot, date 26.10.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh punonjësve të Shoqërisë Rajonale të detyrimeve të Ujësjellës Kanalizimeve Klos, me shkresën nr. 3056 prot, date 10.11.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve të fshatit Bejn, me shkresën nr. 3346 prot, date 11.12.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve të fshatit Plesh, me shkresën nr. 3296 prot, date 04.12.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve të fshatit Bershi, me shkresën nr. 3057 prot, date 10.11.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve të fshatit Unjate, me shkresën nr. 3012 prot, date 08.11.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve të fshatit Plan i Bardh, me shkresën nr. 3453 prot, date 27.12.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve të fshatit Klos-Katund, me shkresën nr. 3453 prot, date 19.12.2023 njoftim për

⁴Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

shlyerje detyrimesh banoreve te fshatit Patin, me shkresën nr. 3503 prot, date 21.12.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve te fshatit Fullqet, me shkresën nr. 3453 prot, date 19.12.2023 njoftim për shlyerje detyrimesh banoreve te fshatit Bel.

Konkluzion: Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet VKB-së nr. 79, datë 21.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.

- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.cdhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlera vetë zbatueshme për legalizim”, pika 5⁵.

Në Bashkinë Klos struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Sektori i Urbanistikës.

Në procesin e legalizimeve për vitin 2023 rezulton se, janë legalizuar 121 objekte, me vlerë totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë 3,147,067.36 lekë, ku 95 subjekte kanë paguar vlerën prej 2,486,046.36 lekë dhe 26 subjekte nuk kanë paguar vlerën prej 661,021 lekë.

Nr	Lloji I objektit	Sip në m2	Nr pasurise	Zona Kadastrale	Vlera e TNI	Likujduar
1	Godine banimi	124m2	220/1/1	3534	20 355	Pa Paguar
2	Godine Banimi	336.4m2	352/1	1909	22 220	Pa Paguar
3	Godine Banimi	121.1m2	33/1	1909	19 879	Pa Paguar
4	Godine Banimi	139.12m2	205/1	2699	22 836	Pa Paguar
5	Godine Banimi	216.13m2	344/1	3439	35 478	Pa Paguar
6	Godine Banimi	142.5m2	517/1/6/1	3439	23 391	Pa Paguar
7	Godine Banimi	242m2	18/1/1	2312	39 724	Pa Paguar
8	Godine Banimi	127.4m2	275/1/1	2312	20 913	Pa Paguar
9	Godine Banimi	105.6m2	429/2/1	2312	17 334	Pa Paguar
10	Godine Banimi	119m2	204/10/1	3534	19 534	Pa Paguar
11	Godine Banimi	153.78m2	103/1	1651	25 243	Pa Paguar
12	Godine Banimi	97.01m2	456/1	1909	15 924	Pa Paguar
13	Social Ekonomik	70.55m2	132/7/2	2164	11 581	Pa Paguar
14	Godine Banimi	300m2	133/2/1	2164	49 245	Pa Paguar
15	Godine Banimi	138.06m2	131/1/5/1	3534	22 660	Pa Paguar

⁵VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Nr	Lloji I objektit	Sip në m2	Nr pasurise	Zona Kadastrale	Vlera e TNI	Likuiduar
16	Godine Banimi	201.76m2	229/1	3680	33 120	Pa Paguar
17	I kombinuar	324.62m2	132/7/1	2164	53 286	Pa Paguar
18	Social Ekonomik	15m2	1/250/1	2161	2 462	Pa Paguar
19	Godine Banimi	37.5m2	139/5/1	3534	6 155	Pa Paguar
20	Godine Banimi	104.4m2	318/14/2	2312	17 137	Pa Paguar
21	Godine Banimi	170.52m2	675/1	1449	27 990	Pa Paguar
22	Godine Banimi	165.6m2	138/2/1	3534	27 180	Pa Paguar
23	Godine Banimi	338.35m2	21/1	2164	55 540	Pa paguar
24	Godine Banimi	60m2	270/3/1	2334	9 850	Pa paguar
25	GodineBanimi	271.5m2	1/188/1	2161	44 570	Pa paguar
26	GodineBanimi	106.09m2	185/9/2	3534	17 414	Pa Paguar
	Nr 26			Shuma	661,021	pa
	Nr			Shuma	0	
					661,021	

Burimi: Bashkia Klos

Konkluzion: Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2023 nuk kanë paguar 26 qytetarë me vlerë totale **661,021** lekë për 25 objekte të legalizuara, **që përbën në të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Klos.** Ndërsa për vitin 2022 kanë qenë debitorë 2 subjekte, të cilët kanë likuiduar detyrimin në vitin 2023, kurse para vitit 2022 nuk ka debitorë, pasi qytetarë kanë likuiduar të gjitha detyrimet për legalizimet e përfituara.

Mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga përfituesit debitorë të legalizimeve janë veprime ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c⁶, me ligjin nr. 98/2020 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vleravet e zbatueshme për legalizim" pika 5⁷, me VKB nr. nr. 79, datë 21.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023".

• **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Në territorin e Bashkisë Klos për vitin 2023 kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregimit të lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023.

Konkluzion: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 4 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregim lëndë djegëse me pakicë, kanë licenca me afat me 5 vjet, të cilat kanë kryer pagesa pjesore dhe të 4 subjektet rezultojnë me detyrime **në vlerë totale 2,200,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Klos.** Subjektet debitorë, që ushtrojnë aktivitet tregim lëndë djegëse me pakicë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
		Fillimi	Mbarimi			

⁶për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksë e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi"

⁷"Taksë vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi"

1	V.	25/06/2019	24/06/2024	1,000,000	0	1,000,000
2	S-sh.p.k	30/03/2021	30/03/2026	1,000,000	600,000	400,000
3	M.oil sh.p.k	11/02/2021	10/02/2026	1,000,000	600,000	400,000
4	Fledi-2015	27/05/2020	26/05/2025	1,000,000	600,000	400,000
				4,000,000	1,800,000	2,200,000

Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pajisur me autorizim, bie në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr.71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*”. Neni 20-Autorizimet pika 2. “*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: zj. F. K. me detyrë ish/Pergjegjese e Sektorit të të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (për periudhen janar-mars 2023) dhe zj. D. M. me detyrë Pergjegjese e Sektorit të të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
- 3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
- 3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.
- 3.4 Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Mat në mbyllje të vitit buxhetor 2023.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**
Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Klos” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin ligjin nr. 25/2018 datë

10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Mat për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr. 901 prot., datë 20.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Klos dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Financës. Është protokolluar në Degën e Thesarit Mat me nr.132 prot., datë 21.03.2024 dhe është miratuar nga Përgjegjësi i Degës Thesarit Mat.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore etj.

Është mbajtur centralizatori për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditaret në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkaku e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhenat te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Totali i Aktivit për vitin 2023 është në vlerën 1,952,388,685 lekë dhe për vitin 2022 është 2,439,787,340 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1		Aktivi i Bilancit 2023	Në lekë	
Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	1,952,388,685	2,439,787,339
2		I.Aktivët Afat shkurtra	416,303,497	443,427,201
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	102,539,606	62,838,227
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	102,539,606	62,838,227
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	25,870,028	29,980,185
12	31	Materiale	2,481,878	3,173,120
13	32	Inventar I imet	23,388,150	26,807,065
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura, ose prane te treteve		

Nr.	Referenca e		Ushtrimi i	Ushtrimi
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone per zhvleresimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	287,893,863	350,608,789
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, parardhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	182,599,799	173,518,674
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	105,294,064	177,090,115
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		II.Aktivet Afat gjata	1,536,085,188	1,996,360,139
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	36,106,179	46,295,425
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	36,106,179	46,295,425
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,371,151,809	1,832,198,249
48	210	Toka, T,roje, Terene	999,520	999,520
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	417,962,535	436,040,707
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	917,632,150	1,353,555,786
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	6,301,129	6,254,016
53	215	Mjete Transporti	13,008,459	15,778,051
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	13,446,006	17,087,280
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	349,730	933,792
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	1,452,280	1,549,098
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	128,827,200	117,866,465
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	128,827,200	117,866,465

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 102,539,606 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 62,838,227 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 102,539,606 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 62,838,227 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.3 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”të pasqyrave financiare.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 25,870,028 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,980,185 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej 4,110,157 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,481,878 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 3,173,120 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 691,242 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në magazinë gjatë vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 23,388,150 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 26,807,065 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 3,418,915 lekë, e cila përfaqëson ulje të inventarit të imët për vitin 2023 nga dalja jashtë përdorimi.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 287,893,863 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 350,608,789 lekë, ku kemi pakësim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat uljes së kreditorëve krahasuar me vitin paraardhës.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 182,599,799 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 173,518,624 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 9,081,125 lekë, e cila ka ardhur nga rritja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2023

Përshkrimi	Gjendje 01.01.2023	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2023
Paga +Tatim shperblimi +Dieta KLSH	554,217			554,217
Ndihme ekonomike KLSH	225,532			225,532
Autorizime KLSH	1,200,000			1,200,000
Humbje materiale KLSH	1,092,520			1,092,520
Zhdëmtime KLSH	1,156,833			1,156,833
Qera trualli +Ndertese KLSH	6,551,188			6,551,188
Gjobë KLSH	210,000			210,000
Ndalesa akt kontrolli 2002-2004	463,593			463,593
Te ardhura te paarketura nga subjektet minerale KLSH	64,927,000			64,927,000
Debitorë kopshti	211,760	157,060	158,880	209,940
Gjopa IVMT	25,372,564			25,372,564
Taksa dhe tarifa vendore	71,553,467	14,325,019	5,242,074	80,636,412
Totali	173,518,674	14,482,079	5,400,954	182,599,799

- **Llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 105,294,064 lekë, e cila rakordon për vlerën 105,294,064 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, e cila përbëhet nga shuma e : llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 90,232,952 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 10,943,439 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 628,298 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,069,820 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 419,555 lekë.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme;
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivitet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivitet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivitet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivitet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivitet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,536,085,188 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,996,360,139 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,031,478,568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,604,523,380 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 36,106,179 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 46,295,425 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 48,492,510 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 53,664,888 lekë, ku diferenca në ulje prej 5,172,378 lekë, përfaqëson shumën e vlerave të projekt-studimeve të shpërndara tek aktivet perkatëse dhe transferimi i një pjese tek Ujësjetllës kanalizime Dibër që i përket investimeve të Ujësjetllës Kanalizime Klos.

Konkluzion: Nga analiza e gjendjes llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në vlerë bruto prej 48,492,510 lekë në fund të vitit 2023, prej 45,732,902 lekë që i përgjigjet vlerës së 45 projekt-studime per investime, ku vlera prej 31,683,734 lekë që i përket 35 projekt-studimeve është e pa shpërndarë sipas aktiveve perkatëse të investuara dhe të kapitalizuara në vitet e mëparshme para vitit 2020. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël, por nuk ka inventar fizik. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **“Pika 2. Klasa 2, Kreu II.”** Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes se kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b.d.** Analiza e projekt-studimeve të pa shpërndara tek aktivet perkatëse pjesë e gjendjes së llog. 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Gjendja 31.12.2022	Gjendja date 31.12.2023	Nr.	Emertimi	Gjendja 31.12.2022	Gjendja date 31.12.2023
1	Projekt Rruga Bel - Unjate	585,400	585,400	19	Studime projektimi Kanali Xibër - Hane	297,500	297,500
2	Projekt Shkolla 9 - vjeçare Klos	661,000	661,000	20	Stud projekt rrug. Autom. Fshati Guri Bardhë	244,080	244,080
3	Projekti "Sistemi asf.rruge e sheshe Q.Klos" (I plote)	3,669,600	3,669,600	21	Projekti "Ndertim Amfiteatri"	196,200	196,200
4	Projekti "Sistemi asf.rruge Ne fshatin Dars"	733,374	733,374	22	Stud proj. rruge Pepaj - Kadillari	190,000	190,000
5	Projekti I rruges "Klos-Bel-Unjate"	1,399,920	1,399,920	23	Projekti "Ndertim dige liqenit teBalgjaj"	392,367	392,367
6	Harta per rregjistrim pasurie pyjore	179,371	179,371	24	Projekt "Rruga Petralbe - Kala" pj eI dt.6.8.2019	588,600	588,600
7	Projekt "Muzeu I Bashkise"	1,004,700	1,004,700	25	Projekti "Ura metalike Klos"	343,317	343,317
8	Projekt "Sist.asfalt.rruga Halili-Pazari I Vjeter"	1,134,720	1,134,720	26	Projekti "Rruga Xiber-Murrize"	539,518	539,518
9	Projekt "Sist.asfalt.rruga Pleshe-Ceruje"	756,480	756,480	27	Projekti "Rikualifikim urban Kodra e Pleshes"	245,200	245,200
10	Projekt "Sist.asfalt.rruga Ceruje-Patin"	886,500	886,500	28	Projekti "Ndertim lulishte ne qytetin Klos"	215,810	215,810
11	"Ndert kana vadi X.Hane-Klos;Fullqet-Klos;Rripe-Gurre-Klos;Kurdari"	4,439,737	4,439,737	29	Projekti "Mrojte lumore Urë - Urë"	1,800,000	1,800,000
12	Projekt "Rikonstr.ki salles se keshillit"	117,600	117,600	30	Projekti "Ndertim I kullës se sahatit"	552,000	552,000
13	Projekt "Rikonstr. Urban lagjija Vesmali-Dakuci"	3,546,000	3,546,000	31	Projekti "Ndertimi I sifonit Mishter"	720,000	720,000
14	Projekt "Qendra kulturore Klos"	1,512,960	1,512,960	32	Projekti "Sifoni PDV KL/UB 437"	252,000	252,000
15	Projekt "Ndertim Tregu Qyteti Klos"	1,122,900	1,122,900	33	Pr."Rruga (segmenti Unaza deri tek kryqezimi)"	276,000	276,000
16	Projekt "Ndertim Ministadiumi"	992,880	992,880	34	Stud Projek Ndert Ura B-A mbi Lumin Mat, Dom,	498,000	498,000
17	Studime projektme rruge X.Hane-Dishaj	702,000	702,000	35	Studime projektme Ndertese Shendetesore	396,000	396,000
18	Stud projekt ndertes shkoll C.U Shkall;X.Hane;L.Muçaj	492,000	492,000		Totali	31,683,734	31,683,734

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2023.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën 1,371,151,809 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,832,198,249 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,982,986,058 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,550,858,488 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2023 ne vlerën prej 999,520 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 999,520 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 paraqiten në vlerën prej 999,520 dhe në mbyllje të vitit 2022 në të

njëjtën vlerë prej 999,520 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" me date 31.12.2022

Nr.	Emertimi i Aktivit	Gjendja date 31.12.2022	Shtesa viti 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Trualli i zyrave te Bashkise Klos	684,960	0	684,960
2	Trualli i stacionit te pompimit Klos-Katund (62 m2)	19,840	0	19,840
3	Trualli i stacionit te pompimit Shengjun (269m2)	94,720	0	94,720
4	Siperfaqja e truallit te pallatit (625 m2)	200,000	0	200,000
	TOTALI	999,520	0	999,520

- **Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 417,962,535 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 436,040,707 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 605,055,964 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 601,297,527 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 3,758,437 leke, që përbëjnë shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si rikonstruksion rruge, Ndërtim Park inovativ rekreacioni etj.

Shënim: Në **gjendjen e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"** sipas inventarit kontabël përfshihen të gjithë aktivet "Ndërtesa e konstruksione" të Bashkisë Klos dhe njësjive Administrative në varësi (Klos, Suç, Xibër dhe Gurrë).

- **Gjendja e Llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 917,632,150 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,353,555,786 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,270,053,171 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,839,724,917 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë pakesimet në vlerën 435,923,636 lekë, duke qenë se aktivet e ujësjellësit i janë transferuar Drejtorisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Dibër, bazuar në Marrëveshjen për Krijimin e Subjektit të Kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve nr.5532 prot., datë 18.07.2022. etj. Amortizimi për vitin 2023 është llogaritur 352,421,021 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 6,301,129 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 6,254,016 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 12,993,042 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,375,042 lekë për të cilat ka inventar fizik. Shtesa prej 618,000 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2023 në krahasim me vitin 2022 përfaqëson blerjet e bëra për kontejnerë metalike, shkallë alumini etj.

- **Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 13,008,459 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,778,051 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 42,200,560 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 41,751,160 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar 29,192,101 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve deri në fund të vitit 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

- **Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 13,446,006 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 17,087,280 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 47,242,151 lekë dhe në mbyllje të vitit

2022 në vlerën kontabël 48,807,720 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 747,800 lekë te pajisjeve dhe pakësime në vlerën kontabël 2,313,372 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përllogaritur është në shumën 33,796,145 lekë.

Gjendja e llogarisë 28 “Caktime aktiveve afatgjata” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,452,280 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,549,098 lekë, diferenca në ulje është vlera e amortizimit e përllogaritur. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 2,506,208 lekë. Kjo shumë përfaqëson vlerën e Objektivit "Ish ndërtesa e kopshtit të fëmijëve të qytetit Klos", i është dhënë në përdorim Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër për Stacionin Policor në Bashkinë Klos, për arsye se stacioni policor i sapo krijuar nuk ka patur ambient në dispozicion.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I. AAG/JO MATERIALE	53,664,888	7,369,463	46,295,425	3,665,657	525,115	8,838,035	1,325,706	48,492,510	12,386,331	36,106,179
Studime dhe kerkime	53,664,888	7,369,463	46,295,425	3,665,657	525,115	8,838,035	1,325,706	48,492,510	12,386,331	36,106,179
II. AAG/ MATERIALE	2,550,858,492	718,660,244	1,832,198,248	234,516,958	6,603,961	802,389,392	179,484,634	1,982,986,058	611,834,249	1,371,151,809
Toka,troje,Terene	999,520		999,520					999,520		999,520
Pyje,Kullota Plantacione			-					-		-
Ndertime e Konstruksion	601,297,527	165,256,820	436,040,707	3,778,453	38,568	20,016	3,155	605,055,964	187,093,429	417,962,535
Rruge,rrjete,vepra ujore	1,839,724,919	486,169,133	1,353,555,786	228,923,305	6,439,005	798,595,053	176,740,684	1,270,053,171	352,421,021	917,632,150
Instal tek,makin,paisje,vegl	12,375,042	6,121,027	6,254,015	618,000	20,970			12,993,042	6,691,913	6,301,129
Mjete transporti	41,751,160	25,973,109	15,778,051	449,400	63,380			42,200,560	29,192,101	13,008,459
Inventar ekonomik	48,807,723	31,720,444	17,087,279	747,800	42,038	2,313,372	1,767,088	47,242,151	33,796,145	13,446,006
AQT te dentuara	3,396,393	2,462,601	933,792			1,460,951	876,889	1,935,442	1,585,712	349,730
Caktime	2,506,208	957,110	1,549,098				96,818	2,506,208	1,053,928	1,452,280
TOTALI (I+II)	2,604,523,380	726,029,707	1,878,493,673	238,182,615	7,129,076	811,227,427	180,810,340	2,031,478,568	624,220,580	1,407,257,988

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Klos

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 203 për Bashkinë Klos dhe Njësitë Administrative në varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023 ka dalë urdhri nr. 143, datë 24.11.2023, “Për Inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2023”.

Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrat e Bashkisë, magazinave dhe në NJA, në shkolla, kopshte, Bibliotekë, vendparkimin e mjeteve. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastet e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023. Është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve. Nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 143, datë 24.11.2023 është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve, ku janë mbajtur procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.

Komisioni ka hartuar relacionin përmbledhës për mbledhjen e aktiveve jashtë përdorimi nga subjektet e inventarizimit dhe argumentimin e vlerësimit të tyre jashtë përdorimi.

Rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive në vlerën lekë, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

1. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,925,842 lekë.
2. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 729,173 lekë.
3. Llog.214 “ Instalime Teknike, Pajisje, Instrumente dhe Vegla Pune” në vlerën 10,735 lekë.

Për asgjësimin e materialeve të nxjerra është ngritur komisioni me Nr.64 datë 24.04.2024 “Për ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit/tjetërsimit të aktiveve të panevojshme për vitin 2023”, i cili ka vazhduar punën për shpërbërjen e aktiveve pa vlerë përdorimi për ti mbledhur pranë magazinës dhe për ti bërë hyrje duke ndarë veç skrapin dhe materialet prej druri.

Konkluzion: Nga auditimi i gjithë procedurës së inventarizimit rezulton se, nuk ka përfunduar procedura e klasifikimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi në ato që mbetjet e tyre kanë akoma vlerë përdorimi dhe kthimi i tyre në magazinë si dhe ato mbetje që nuk kanë vlerë përdorimi e vazhdimi për asgjësimin e tyre. Gjithashtu është kryer inventarizimi fizik i AAGJM të përfshira gjendje në llogaritë: 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Ndërsa në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë rregjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet, kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre” pika 26, 27,30.

- **Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale”** paraqitet në bilanc në vlerën 624,220,580 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes Përgjithshme” pika 36. Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Për aktivet e llogarive: 202 “Studim-Projektme”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”, në të cilat përfshihen paisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është aktiv për aktiv, dhe mund të verifikoheshin se si janë llogaritur amortizimi për pajisjet kompjuterike.

- **Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet me vlerën prej 128,827,200 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 117,866,465 lekë, për të cilën u paraqit analiza e mëposhtme:

NR.LL OG	OBJEKTET NË PROCES	VLERA GJENDJE 31.12.2023 (NE LEKE)
2120101	Rikonstr.Zyra e Keshillit (Ish NFP)	2,000,000
2120101	Mbikqyrje Rikonstr.Zyra e Keshillit (Ish NFP)	94,000
2120101	Mbikqyrje Rikonstr.Zyra e Keshillit	24,900
2120103	Rikonstr.i Shkolles mesme Klos	78,923,350
2120103	Rikonstr.i Shkolles mesme Suç	16,125,000
SHUMA 212		97,167,250
2131100	Ndërtim I rruges se fshatit Xiber Murrize, Nj. Adm Xiber	1,500,000
2133100	Sistemim KUZ dhe KUB , ne rrugen Riza Beg Çela dhe Murat Basha	20,110,610

NR.LL OG	OBJEKTET NË PROCES	VLERA GJENDJE 31.12.2023 (NE LEKE)
2132100	Ndërtim Ure beton arme 4*17 m ne fshatin Dom	10,049,340
	SHUMA 213	31,659,950
	SHUMA TOTALE 212 + 213	128,827,200

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
			viti 2023	viti 2022
65	B	PASIVET (DETYRIMET)	314,199,891	372,336,554
66		I.Pasivet Afat shkurtra	314,199,891	372,336,554
67		1. Llogari te Pagushme	314,199,891	372,336,554
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	90,232,952	163,475,216
69	42	Detyrime ndaj personelit	10,943,439	9,967,464
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	628,298	455,173
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	3,069,820	2,808,459
76	436	Sigurime Shendetsore	419,555	383,803
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie mes institucione apo njesi ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	26,306,028	21,727,765
82	467	Kreditore te ndryshem		
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	182,599,799	173,518,674
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera passive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,638,188,794	2,067,450,786
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,638,188,794	2,067,450,786
98	101	Teprica (Fondi I akumuluar)/Deficiti akumuluar	1,550,574,995	2,021,803,791
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	76,233,578	41,110,462
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim	11,380,221	4,536,533
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,952,388,685	2,439,787,340

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,952,388,685 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,439,787,340 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

-Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje

të vitit 2023 në vlerën 90,232,952 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 163,475,216 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje me një pakësim në shumën 73,224,264 lekë krahasuar me vitin 2022 duke qenë se janë likuiduar disa detyrime të prapambetura gjatë vitit 2023. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks:

Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

LLOG.	Emertimi	Nr.Fature	Date Fature	Gjendje me 31.12.2022	Likuiduar	Shtesa	Gjendje me dt.31.12.2023
404	Sistemim KUZ dhe KUB Klos	92/2022	28.12.2022	641,774	641,774		0
404	Mbikqyrje Siste KUZ dhe KUB Klos	77/2022	28.12.2022	17,628	17,628		0
404	Rikonstruksion kanali Ceruje	195/2022	27.12.2022	2,192,620	2,192,620		0
404	Kolaudim Rikon kanali Ceruje	78/2022	27.12.2022	13,800	13,800		0
404	Sist asfal rruga Pleshe-Ceruje-Patin	95/2022	31.12.2022	122,640,270	63,506,931		59,133,339
404	Sist.asfaltim rruga Dars	375	02.06.2013	2,693,694			2,693,694
404	Sist.asfaltim rruga Dars	489	18.07.2015	5,968,453			5,968,453
404	Rik.shkolla Gurr e Vogel	19	29.05.2014	1,000,000			1,000,000
404	Rikon.shkol mesme Sh Çollaku Klos	46	27.04.2020	1,484,515			1,484,515
404	Mbikq Sist asfa ne lagjet e qytetit Klos			78,240	78,240		0
404	Kolaud.Rik.shkol mesme Sh Çollaku	16	27.04.2020	102,000			102,000
404	Rik.shkolle mesme Shaban Çollaku Klos	46	27.04.2020	7,447,003			7,447,003
	Ndertim Muzeu Historik-Kulturor	8/2021	03.09.2021	1,001,255	926,529		74,657
	Ndertim Muzeu Historik-Kulturor	27/2021	27.09.2021	9,611,169	1,601,862		8,009,307
404	Krijimi I tabel inf. pikat turistike (BE)	29/2021	30.09.2021	717,600	119,600		598,000
	Vendosja e shenjave per hiking (BE)	15/2021	27.09.2021	1,153,920	192,320		961,600
	Mbik. Ndertim Muzeu Historik-Kulturor	17/2021	29.09.2021	223,273	37,212		223,273
	Sist-asf.rr Pleshe-Ceruj e rr Ceruj-Patin	55/2022	06.09.2022	3,535,396	3,535,396		0
	Rrethim varrezash	195/2023	13.07.2023			449,460	449,460
404	TVSH per park inovativ rekreacioni	14/2023	25.10.2023			583,824	583,824
404	Shuma 404			160,522,610	72,863,912	1,033,284	88,691,913
				-	-		-
401	Shperblime lindje			1,350,000	1,350,000		0
401	Vend Gjq Nuredin Vaka per larg.puna			582,848	-	-	582,848
401	Sherbimi postar dhjetor 2022	524/2023	04.01.2023	19,875	19,875		0
401	Sherbimi postar dhjetor 2022	562/2023	06.01.2023	418,720	418,720		0
401	Qera ambjenti per kopshtin Suç			60,000	60,000		0
401	Shpenzime sporti			409,978	409,978		0
401	Shperbl komos I perhershem I pranimit			20,000	20,000		0
401	Shpenzime udhetime dieta			43,500	43,500		0
401	Page shperblim L.Zeqiri neto			47,685	47,685		0
401	Shërbim postar dhjetor 2023	486/2024	18.01.2024	-		26,905	26,905
401	Shërbim postar dhjetor 2023	524/2024	07.01.2024			297,376	297,376
401	Qera ambjenti per kopshtin Suç					60,000	60,000
401	Shpenzime sporti					493,910	493,910
401	Aktivi kulturore per ngjarje historike	31/2023	31.12.2023			80,000	80,000
	Shuma 401			2,952,606	2,369,758	958,191	1,541,039
	Totali 404+401			163,475,216	75,233,670	1,991,475	90,232,252

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë në gjendjen e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **90,232,252 lekë** janë përfshirë 15 fatura të paguara në vlerën 89,311,973 lekë të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit të vitit ushtrimor të mbyllur, të cilat duhet të ishin pjesë e gjendjes e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III pika 3.1 nënpik 42, Aneksi 1 pika 3.3/c, ku përcaktohet se: “c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë”.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 10,943,439 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 628,298 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 3,069,820 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:

a. Sigurimet shoqërore 9.5% punëmarrësi vlera 1,172,280 lekë.

b. Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 1,850,961 lekë.

c. Sigurimet shoqërore suplementare punëmarrësi vlera 46,579 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 419,555 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarësi vlera 209,778 lekë.

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 209,777 lekë.

Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 182,599,799 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 156,471,497 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërpartit 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 26,306,028 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 21,727,765 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Mat në mënyrë analitike. Analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 107 “Për vlerën e mjeteve të caktuara në përdorim”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,380,221 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,536,533 lekë. Kjo llogari merr në kredi vlerën neto të aktiveve afatgjata që institucioni merr në përdorim nga të tretët, me kundërpartit debitin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJ. Teprica e saj tregon se këto aktive nuk janë të vetat. Vlera prej 11,380,221 lekë përfaqëson aktive afatgjata të caktuara për përdorim si më poshtë:

1. “Urë tip Bailey Pazari i Vjetër” Dars me vlerë fillestare 2,707,175 leke (me vlere të mbetur datë 31.12.2023, 1,957,275 lekë) është marrë në përdorim nga Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr.4040 në ndihmë të komunitetit të njësisë Administrative Xibër sipas Akt-Marreveshjes nr.84/2 Regj.Tiranë me datë 19.04.2016 dhe Nr.815 Regj.Klos me datë 28.04.2016.

2. “Urë tip Bailey fshati Mishtër”, me vlerë fillestare 2,850,660 lekë (me vlerë të mbetur datë 31.12.2023, 2,352,432 lekë) është marrë në përdorim nga Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr.493/2 Rregj. në ndihmë të komunitetit të njësisë Administrative Gurrë, fshati Mishtër, sipas Akt-Marrëveshjes nr.493/2 Regj.Tiranë me datë 12.03.2020 dhe Nr.991/2 Regj.Klos me datë 31.03.2020.

3. “Urë tip Bailey fshati Xibër Hane”, me vlerë fillestare 2,381,724 lekë (me vlerë të mbetur datë 31.12.2023, 2,312,257 lekë) është marrë në përdorim nga Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr.766/2 Rregj. në ndihmë të komunitetit të njësisë Administrative Xibër Hane, fshati Xibër Hane, sipas Akt-Marrëveshjes nr.766/2 Regj.Tiranë me datë 14.04.2023 dhe Nr.1176 Regj.Klos me datë 14.04.2023.

4. “**Urë tip Bailey fshati Xibër Murrizë**”, me vlerë fillestare 4,943,644 lekë (me vlerë të mbetur datë 31.12.2023, 4,758,257 lekë) është marrë në përdorim nga Ministria e Mbrojtjes, në ndihmë të komunitetit të njësisë Administrative Xibër, fshati Xibër Murrizë, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 1878/4 Regj.Tiranë me datë 21.11.2022 dhe Nr.2980 Regj.Klos me datë 21.11.2022.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”(Aneksi nr.B/9) të PF të vitit 2023 paraqitet më poshtë:

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 612,003,893 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Mat paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 15,023,532 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 81,369 lekë e cila përfshin *Taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 2,599,330 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

Gjendja e llogarisë **7029 “Të tjera tatime mbi pasurinë”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 36,390 lekë e cila përfshin *taksën e kalimit të pronësisë*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 12,306,443 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 7,849,551 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 5,685,075 lekë, e cila përfshin qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 2,164,476 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 105,294,064 lekë, e cila rakordon me gjendjen në vlerën 177,090,115 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo, e cila është e saktë dhe reale, pasi pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 537,913,172 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli”** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 131,050,376 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 131,050,376 lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë **601 “Kontribute për sigurime”** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 21,853,153 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 21,853,153 lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 46,710,132 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 46,710,132 lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 18,996,686 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 18,996,686 lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 318,755,865 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Po kështu për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 612,003,893 lekë dhe totali shpenzimeve është 535,770,315 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 76,233,578 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën 546,960 lekë .

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 82,700,930 lekë në analizë tregon burimet e investimit. Investimet sipas projekteve me të dhënat e kontratave të tyre dhe likuidimet e tyre sipas periudhës 3 vjecare paraqitet në tabelën e mëposhtme
- Zëri **“Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale”** formati 6 e plotësuar për shumën 128,827,200 lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitin 2023 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet e arkëtimit kryhen me arkë, për të gjitha rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, pagesat e kopshtit, ujit të pijshëm, tarifave të biznesit...etj, dhe në fund të çdo jave derdhjet e arkës bëhen në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga

punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari dhe Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për të gjithë ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, është mbajtur edhe një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z.S.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe në cilësinë hartuesit të pasqyrave financiare.

3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve kontraktore

Në realizimin e auditimit të kësaj pike të programit e u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të transferuara në pronësi/përdorim me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.

2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për paisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

➤ **Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Klos paraqiten, sipas VKM-ve.** Referuar të dhënave të Zyrës së Menaxhimit të Aseteve rezultoi se, janë 650 prona të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Klos dhe

3 e Njësive Administrative, listat përfundimtare të cilave janë të miratuara me VKM-së përkatëse. Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Njësia Vendore	VKM		Në Pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Gjithsej prona te palujtshme te transferua	Faza e transferimit	Prona pyje dhe kullota	Faza e transferim	Nga këto regjistruar
		Numër	Datë							
1	Ish Bashkia Klos	880	11.06.2008	0	93	93	Fillestare	810	perfundim	0
2	Ish Komuna Suç	618	14.05.2008	0	142	142	Fillestare	185	perfundim	0
3	Ish Komuna Xibër	1262	17.09.2008	0	56	56	Fillestare	110	perfundim	0
4	Ish Komuna Gurrë	402	22.04.2009	0	104	104	Fillestare	104	perfundim	0
	Shuma					395		1209		

- Për **Bashkinë Klos** (Bashkia Qendër) janë transferuar 93 prona, ku me VKM nr., datë 02.09.2009 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Bashkisë Klos, të Qarkut të Dibër”(93 prona) dhe me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Transferimin ne pronesi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit të Ish-komunave/bashkive”.

- Për **Njësinë Administrative Suç** janë transferuar 142 prona, nga të cilat pyje e kullota 185. Pronat në pyje dhe kullota janë transferuar në fazë përfundimtare me VKM nr.885, datë 11.06.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota që do të transferohen në përdorim të njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Komuna Suç të Qarkut Diber. Ndërsa pronat e paluajtshme janë transferuar në fazë fillestare me VKM Nr.618, datë 14.05.2008 “Për Miratimin e Listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Suç, të qarkut të Diber”.

- Për **Njësinë Administrative Gurre** janë transferuar 104 prona të paluajtshme, pyje dhe kullota jane 61 prona të paluajtshme. Pronat në pyje dhe kullota janë transferuar në fazë përfundimtare me VKM nr.881, datë 11.06.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Komuna Gurre të Qarkut të Diber”. Ndërsa 104 pronat e paluajtshme janë transferuar në fazë paraprake me VKM Nr.402, datë 22.04.2008 “Për Miratimin e Listës fillestare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunes Gurre, të qarkut Diber”.

- Për **Njësinë Administrative Xibër** janë transferuar 56 prona të paluajtshme, 110 jane pyje dhe kullota prona të paluajtshme. Pronat në pyje dhe kullota janë transferuar në fazë përfundimtare me VKM nr.881, datë 11.06.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota që do të transferohen në përdorim të njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Komuna Xibër të Qarkut Diber”. Ndërsa 56 pronat e paluajtshme janë transferuar në fazë fillestare me VKM nr.1262, datë 17.09.2008 “Për Miratimin e Listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komuna Xibër të Qarkut Diber”.

- **Pyjet dhe Kullotat**, janë transferuar në mënyrë të përmblodhur për gjithë territorin e Bashkisë Klos në mënyrë përfundimtare gjithsej 1209 prona pyje-kullota me VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave /Bashkive” të ndryshuar, ku sipërfaqja e transferuar është *gjithsej 23254 ha, nga këto:*

- Pyje 16635.7 ha,
- Kullotë dhe Livadhe 2504 ha
- Toka jo produktive, inproduktive 2143.17 ha

- Shkëmbore dhe ujore 347.5 ha
- Bimësi pyjore 1623.9 ha etj.

➤ Asetet e rregjistruara si pronë e Bashkisë pranë ASHK-Drejtoria Vendore Mat

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se nga Bashkia Klos është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjor për 2 prona të paluajtshme nga pronat e transferuara me VKM, të cilat janë dërguar me shkresë pranë ASHK, Drejtoria Mat. Nga pronat e transferuara nuk ka aplikime për certifikatë pronësie.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të aseteve rezulton se, janë prona 93 të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Klos (Qendër), listat fillestare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse. Nga këto prona janë hipotekuar 0 pasuri të paluajtshme, nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave të këtyre pronave, pasi duhet që nëpërmjet verifikimit në terren, dokumentacionit dhe korrespondencës zyrtare me institucionet përkatëse për statusin e tyre duhen identifikuar e propozuar e marrjen masave për ndjekjen e procedurave ligjore për të vepruar me ato prona që janë inekzistente fizikisht, të zaptuara, të kthyer prona apo të privatizuara, të cilat duhen identifikuar në listat e pronave.

Bashkia Klos nuk ka strukturë të ngritur për menaxhimin e aseteve, përveç një specialisti me emërtim “Inspektor i pronave publike” pjesë e Sektorit të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave” dhe në Rregulloren e Brendshme të miratua nga Titullari i institucionit, Mungesa e kësaj strukture ka sjellë mungesë të kapaciteteve të plota për të kryer proceset e kalimit në pronësi përfundimtare të pasurive të Bashkisë Klos. Për këtë detyrim ligjor Titullari i Bashkisë nuk ka nxjerrë asnjë urdhër për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e gjendjes faktike të pronës në terren dhe matjen faktike të pasurisë, për kryerjen dhe verifikimin e gjendjes juridike të pronës nëpërmjet ASHK për informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, përpunim i të dhënave të hedhura në sistemin përkatës të secilës pasuri sipas ZK, plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për çdo pronë dhe dërgimi i dosjes përkatëse me listën e pronave shtetërore të përditësuar pranë DV-ASHK Mat.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos inventarizimi dhe përditësimi i listave fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 4 Nj.Adm Klos, Suç, Gurre dhe Xibër më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuara, si dhe vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

➤ Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.

Bashkia Klos në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 24 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Nga të cilat 9 kontrata të lidhura në vitin 2023 dhe 15 kontrata ekzistuese. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-30 vjet, të cilat nuk janë të noterizuara. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e parcelave nga fondi i tokave të pandara, parcelave nga fondi pyjor dhe kullor, për aktivitet bujqësor, për pemëtari, Antena, ruge nga miniera, ngritje fabrike përpunimi, studim-kërkim-zbulim minerali, Hec, agroturizëm etj. Kontrata e qiradhënies të lidhura nga Bashki Klos me treguesit e tyre pagesat dhe detyrimet e papaguara paraqiten në Aneks.

Konkluzion: Nga verifikimi i dokumentacioni e dosjeve të kontratave dhe pagesave të kryera rezulton se, në fund të vitit 2023 paraqiten 13 subjekte qiramarrës (sipërfaqe pyjore) me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 2,219,127 lekë**, veprime këto në kundërshtim me kontratat e lidhura të qiradhënies neni 4 “vlera e qirasë vjetore” dhe neni 5 “pagesa dhe rregjimi i saj”.

Konkluzion: Në 4 raste të debitorëve në kontratat e tyre në nenin 3 “afati i kontratës”, nenin 4 “Vlera e kontratës” ose në nenin 5 “pagesa edhe rregjimi i saj” është përcaktuar se: “*Kjo kontratë i fillon efektet ligjore dhe financiare në momentin e paisjes së subjektit me lejen e ndërtimit nga qiramarrësi dhe dorëzimin e saj Bashkisë Klos*”. Në këto raste pavarësisht se nuk është marrë leja e ndërtimit (në AZHT), nga këto shoqëri për objektin e kryesor të kontratës, parcelat e marra me qira nga fondi pyjor-kullor kanë vazhduar ti mbajnë të bllokuara mbi 1 vit, duke mos lejuar Bashkinë ti ketë në dispozicion për vënie në shfrytëzim nga qiramarrës të tjerë me pasojë shkaktimin e të **ardhurave të munguara në vlerën 1,663,905 lekë** për buxhetin e Bashkisë Klos. Rastet paraqiten të detajuara më poshtë:

1. Shoqëria “K Sh.p.k & B. I” shpk me objekt kontrate të lidhur me datë 26.06.2023: “*Dhënie në përdorim 2.5 ha sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor publik për ndërtim të parkut fotovoltaiik “S. K.” për prodhimin e energjisë (për ndërtim teleferik pasagjerësh, ose linjë të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike stacionet dhe objektet përkatëse)*”, me afat 10-vjecar dhe detyrim vjetor në vlerën 440,000 lekë.

2. Shoqëria “G. E.” shpk me objekt kontrate të lidhur me datë 25.11.2022: “*Dhënie në përdorim 1.4995 ha sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor publik për ndërtim të HEC-eve, 4.170 km për ndërtimin e linjës 110 kw, dhe rrugë kalimi me gjatësi 0,988 km*”, me afat 10-vjecar detyrim vjetor në vlerën 140,950 lekë.

3. Shoqëria “L. T.” shpk me objekt kontrate të lidhur me datë 20.11.2020: “*Dhënie me qira e sipërfaqes prej 1 ha për ndërtim stalle bagëtiqe, sipërfaqe pyjore në ekonominë pyjore Balgaj në pronësi të bashkisë Klos*”, me afat 10-vjecar dhe detyrim vjetor në vlerën 80,000 lekë.

4. Shoqëria “G. I. G.” shpk me objekt kontrate të lidhur me datë 03.09.2018: “*Dhënie në përdorim 0,420 ha sipërfaqe e fondit pyjor dhe kullor publik me gjatësi 4,223 km për shtrirjen e tubacioneve të çelikut të një sipërfaqe me gjatësi 3360 km linjë e tensionit dhe rrugët lidhëse për të bërë kalimin nga rruga kryesore për në sipërfaqen e marrë në përdorim për ndërtim të Hidrocentralit “D.”*”, me afat 10-vjecar dhe detyrim vjetor në vlerën 732,955 lekë.

5. Shoqëria “D. G.” shpk me objekt kontrate të lidhur me datë 10.12.2019: *“Dhënie në përdorim sipërfaqe e fondit pyjor dhe kullor publik me gjatësi 5102.57ml për shtrirjen e linjës së dytë të tensionit dhe rrugët lidhëse për të bërë kalimin nga rruga kryesore për në sipërfaqen e marrë në përdorim për ndërtim të Hidrocentralit “D.”, me me afat 10-vjecar dhe detyrim vjetor në vlerën 270,000 lekë.*

Konkluzion: Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezultojnë se në territorin e Bashkisë Klos ushtrojnë aktivitetin subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Klos. Nga të cilat në 29 raste te subjekteve ushtrojnë aktivitet për prodhim nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit krom dhe për prodhim nxjerrje dhe shfrytëzim të gurëve gëlqeror, ku ushtrimi i aktivitetit të tyre ka filluar me miratime e lejeve për prodhim nxjerrje dhe shfrytëzim të mineraleve në harkun kohor nga 1999-2023. Nga Bashkia Klos janë dërguar njoftime në 21 raste shoqërive që ushtrojnë aktivitet në parcelat pyjore-kullorë pronë/përdorim të bashkisë për detyrimin që kanë për lidhje kontrate qiramarrje për sipërfaqet që shfrytëzojnë. Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneks.

Nuk është zbatuar pika 4 të nenit 4, ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar për subjektet private me objekt veprimtarine prodhim, nxjerrje dhe shfrytëzim të minerave.

Nuk është miratuar ndryshimi nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në Republikën e Shqipërisë, veprim në kundërshtim pikat 3, 5 e 8 të nenit 5 të ligjit 57/2020 “Për Pyjet” (nenin 17 “Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar” të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.)

-Nga ana e Bashkisë Klos bazuar në pikat 3 e 4 të nenit 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” nuk ka asnjë kontratë të nënshkruar me subjektet që ushtrojnë veprimtari të kryerjes së operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor, ku në **pikën 3** përcaktohet se: *“3. Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.”* dhe në **pikën 4** përcaktohet se: *“Bazuar në pikën 1 të këtij neni, cmimet dhe tarifatat për dhënie dhe shfrytëzimin e fondit pyjor miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat . Pronarët privatë, për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara”.*

Nga Bashkia Klos nuk është kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe. Gjithashtu nëpërmjet i është kërkuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Për shfrytëzim të parcelave pyjore për rrugë të përdorura për transport minerali nga miniera në rrugë kryesore, për sipërfaqe të përdorura për venddepozitim minerali, ndertim ngrehinash etj nga Bashkia Klos nuk janë nënshkruar kontrata qiraje me subjektet private. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 391, datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z.I. H. në funksionin e ish-Kryetarit të Bashkisë Klos, z. V. K. në funksionin e Kryetares aktuale të Bashkisë Klos, zj. D. M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, zj. B. P. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Pyjeve dhe z. K. A. me detyrë specialist i pronave në Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

Sqarim dhe shpjegime: Observacioni i sjellë me shkresën 1082/10 datë 04.06.2024, protokolluar në KLSH me nr.prot.492/3, datë 07.06.2024 nga zj. D. M. dhe z.K. A.

Pretendimet e Subjektit të audituar.

- Koncretisht në pikën 2.24 menaxhimi i borxhit sqarohet se vlera e detyrimeve progresive në fund të vitit 2023 është 80,636,412 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë shuma e detyrimeve nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve. Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga 01.01.2023-31.12.2023 nuk është sjellë asnjë informacion apo shkresë që të na vejë në dijeni për detyrimet, këto vlera nuk janë nxjerrë debitorë nga na jonë pasi kjo është realizuar nga strukturat përkatëse.

- Përsa i përket pikës 2.4 edhe pse janë bërë njoftimet për shlyerje të detyrimeve, subjektet L. T, D. G, G. I, G. E., K. shpk-B I., nuk pranojnë të shlyejnë pagesë sepse bazuar në kontratën e marrjes me qira të fondit pyjor-kullor është specifikuar një nenn që subjektet fillojnë pagesën në momentin kur ato pajisen me leje ndërtimi për objektin që pretendojnë. Pranë sektorit të të ardhurave nuk është depozituara asnjë vlerë detyrim, kjo bazuar pretendimit të sipërcituar.

- Në lidhje me subjektet minerare që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Klos, për subjektin “S. B. M.” shpk kemi patur disa kërkesa për marrje në shfrytëzim të gurit gëlqeror, nuk kemi lidhur kontratë, pasi me konsultimet publike nuk kemi gjetur bashkëpunim. Në planin e përgjithshëm vendor miratuar në VKB nr.8, datë 05.03.2018, nuk ka përcaktuar vende për shfrytëzim gurorë. Ndërsa subjekti “B.” shpk dhe “B-P” shpk e kanë pezulluar përkohësisht aktivitetin.

-Kemi kërkesa nga subjektet minerare për heqje/dhënie në përdorim, jemi në proces për fillimin e procedurave për plotësimin e dosjeve. Janë njoftuar të gjithë subjektet për bllokim aktiviteti me shkresën me nr.2991, datë 09.08.2023. Kemi ngritur grupin e punës me shkresën nr.113 datë 26.07.2021, ku janë bërë matjet në terren për sipërfaqen që subjektet kanë në shfrytëzim (karrierat) dhe i kemi njoftuar për t’u paraqitur. Me urdhrin nr.82 datë 09.06.2022, është ngritur komisioni për verifikimin dhe matjen e trojeve në përdorim nga subjektet private me leje minerare.

- Për rregjistrimin e pronave sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, Bashkia Klos nuk është dakort me VKM nr.360, datë 29.05.2019, për përcaktimin e hartës së kufijve administrativo-territoriale vendore, pasi është cënuar territori nga Bashkitë Dibër, Mat dhe Bulqizë me

rrëth 3000 ha. Për këtë kemi derguar shkresa drejtuar Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Brendshme, Prefektit të Qarkut Dibër, Bashkive Mat, Dibër dhe Bulqizë, si dhe ZRPP Dibër, Bulqizë dhe Mat.

Qëndrimi i Grupit të KLSH

Në lidhje me observacionin e subjektit të audituar sqarojmë se merren në konsideratë pjesërisht, duke u reflektuar në projektraportin e auditimit faktet e reja të sjella dhe të shoqëruara me dokumentacion. Përsa i përket debitorëve të kontratave janë ndarë shoqëri me detyrime kontraktore të papaguara dhe shoqëri, që kanë bllokuar sipërfaqe pyjore-kullosore nëpërmjet kontratave të qiramarrjes duke shkaktuar të ardhura të munguara për vlerën e qirasë të kontraktuar. Ndërsa për masat e marra për njoftimet e debitorëve, nisjen e procedurave për evidentimin e parcelave që shfrytëzohen nga subjektet private të licencuara (mbledhje e dokumentacionit të tyre) dhe korespondencës zyrtare të zhvilluar nga ana e bashkisë Klos në lidhje me transferimin dhe regjistrimin e aseteve dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor, janë hapa të pamjaftueshëm për realizimin e administrimit dhe menaxhimin e plotë të aseteve.

2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

2.4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Klos ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 865/9, datë 24.01.2024, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Klos nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Klos, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Klos ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr. 205/9 prot., datë 31.07.2023, por nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, ku përcaktohet që: “Për

të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë”.

IV. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Klos administruar në KLSH me nr. 205/9 prot., datë 31.07.2023, janë rekomanduar gjithsej:

- **18** masa organizative;
- **3** masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 3masa në vlerën 63,396,341 lekë.
- **3** masa disiplinore.

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Klos të Kryetarit të Bashkisë z. V. K. me nr. 865/8 prot., datë 29.12.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	18	18	0
Masa të ardhura të munguara	3 63,396,341	3 63,396,341	0
Masa disiplinore	3	3	0
Totali	24	24	0

VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Klos:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	18	1	1	11	5
Masa të ardhura të munguara	3 63,396,341	0	1	2	0
Masa disiplinore	3	0	0	0	3
Totali	24	1	2	13	8
Totali në %	100%	5%	8%	54%	33%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. Masa organizative.

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Klos, të marrë masa për hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit për 6 – mujorin paraardhës, për plotësimin e dokumentacionit dhe kërkesave, në dosjet e auditimit, që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe për krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos nuk ka marr asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimi është i pazbatuar.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të ndërpresë praktikën e krijimit të debitorëve dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezulton se në Bashkinë Klos gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2022 rezulton në vlerën 71,553,467 lekë, gjatë vitit 2023 janë*

paguar detyrime në total në vlerën 5,242,074 lekë, nga shtesat duke zbritur pagesat janë në vlerën 14,325,019 lekë, kështu gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 80,636,412 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar.

Rekomandimi konsiderohet në proces

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Klos të kryejë kontabilizimet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llogjit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektime të duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezulton se nuk është marr asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është pa zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit duke saktësuar veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke i evidentuar në librin e madh apo centralizator dhe në librin e veprimeve të ndryshme.

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezulton se është mbajtur centralizatori për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

Rekomandimi është në proces.

6.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Klos, të ngrejë urdhër për monitorimin e kontratës, së karburantit me qellim që furnizimi nga operatori ekonomik të jetë në përpurthje me kushtet kontratës.

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos nuk ka marr asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

7.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosja dhe vlerësimi i çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar.

Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Klos në bashkëpunim me komisionin e prokurimit për procedurat me vlera të vogla të marrë masa që në momentin e hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, që të shmanget mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Klos në bashkëpunim me sektorin e Financës të marrë masa që për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Koment: *Nga verifikimi rezulton se bashkia Klos ka bërë njoftimet për likuidimin e faturave.*

Rekomandimi konsiderohet në proces.

10.1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla në çdo rast të argumentojë kryerjen e Procedurave të prokurimit sipas nevojës së sektorëve të ndryshëm të Bashkisë.

Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

11.1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla të kryejë përlllogaritjen e fondit limit për të gjitha procedurat e prokurimit për të cilat nuk ka një urdher nga titullari i institucionit për krijimin e një komisioni për përlllogaritjen e fondit limit.

Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

12.1. Rekomandimi: Nga DPTSHIP Klos të merren masa për të kërkuar plotësimin e të gjitha kriterëve të nevojshme për hartimin e dokumentit të rilevimit topografik, për të gjitha ato raste që do të pajisen me leje ndërtimi / zhvillimi dhe plotësimin me dokumentacionin e plotë të çdo certifikatë përdorimi.

Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

13.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Klos të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Nga Bashkia Klos të merren masa për shqyrtimin brenda afateve kohore të kërkesave për pajisje me leje ndërtimi.

-Nga Bashkia Klos të merren masa për respektimin e të gjitha kriterëve të përcaktuara, për rregullimin e veprimtarisë ndërtimore të subjekteve zhvilluese.

Koment i grupit të auditimit: *Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

14.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Klos të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

15.1. Rekomandimi: Nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të merren masa për respektimin e të gjitha afateve kohore në lidhje me mbajtjen e procedurave përkundrejt kundërvajtësve, sipas përcaktimeve ligjore.

Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

16.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkinë Klos të marrë masa dhe të ngrejë grupet e punës për të kryer inventarizimin e asteve sipas llojit të asetit dhe të marrë në dorëzim me procesverbale, përkatëse për çdo aset.

-Drejtoria e financës në bashkëpunim me drejtorinë e menaxhimit dhe asetëve, dhe Drejtorinë e Pyje/kullota, të marrin masa për marrjen e informacionit të sakta ,për regjistrimin e pronave si dhe për të hapur regjistra kontabël për çdo aset që bashkia ka të inventarizuara.

Koment i grupit të auditimit: Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

17.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në Bashkinë Klos në bashkëpunim me Sektorin e pyjeve/kullota, të marrin masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin e ekonomive pyjore, një numër të madhe të pronave të pa inventarizuara dhe të pa reregjistruara, çka bën të pa qartë nr. e pronave sipas listave të inventarëve, pronë të bashkisë, për verifikim në terren në nëse këto prona janë të lira të zaptuara ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta.

-Sektorin e pyjeve të marrë masa që të hartohen planet e mbarështimit pasi “Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) të ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, b) të hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet”.

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos nuk ka marr asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar.

18.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Klos të vendosen marrëdhënie kontraktuale me operatorët ekonomikë, duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 797.11 ha, duke aplikuar tarifatat të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**49,420,820 lekë për 21 subjekte**)

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos ka bërë njoftimet për lidhjet e kontratave për 20 subjekte, por nuk është marr asnjë masë e mëtejshme për zbatimin e këtij rekomandimi

Rekomandimi zbatuar pjesërisht

B. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos ka nxjerre te gjitha njoftimet për njohje me detyrimet taksa dhe tarifa vendore për subjektet (biznese dhe familjare).*

Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Sektori i Taksave ka njoftuar subjektet si me poshtë:

-Me shkresën nr. 3348 prot, datë 11.12.2023 ka njoftuar 97 subjekte (biznes i vogël);

-Me shkresën nr. 3348 prot, datë 11.12.2023 ka njoftuar 97 subjekte (biznes i vogël) dhe 32 subjekte (biznes i madh);

-Me shkresën nr. 2872 prot, datë 24.10.2023 janë njoftuar te gjithë punonjësit qe janë te punësuar pranë Qendrës Shëndetësorë Klos;

-Me shkresën nr. 2873 prot, date 24.10.2023 njoftim për te gjithë punonjësit Kopshti Klos,

-Me shkresën nr.2871 prot, date 24.10.2023 njoftim për detyrime te punonjësve OSHE,

-Me shkresën nr. 2885 prot, date 25.10.2023 njoftim detyrime për punonjësit Fasonerisë,

-Me shkresën nr. 2869 prot, date 24.10.2023 njoftim për punonjësit e Arsimit,

-Me shkresën nr. 2897 prot, date 26.10.2023 njoftim detyrime punonjësve te Shoqërisë Rajonale te detyrimeve te Ujësjellës Kanalizimeve Klos,

-Me shkresën nr. 3056 prot, date 10.11.2023 njoftim për detyrime banoreve te fshatit Bejn,

-Me shkresën nr. 3346 prot, date 11.12.2023 njoftim për detyrime banoreve te fshatit Plesh,

-Me shkresën nr. 3296 prot, date 04.12.2023 njoftim detyrime banoreve te fshatit Bershi,

-Me shkresën nr. 3057 prot, date 10.11.2023 njoftim detyrime banoreve te fshatit Unjate,

-Me shkresën nr. 3012 prot, date 08.11.2023 njoftim detyrime banore te fshatit Plan i Bardh,

-Me shkresën nr. 3453 prot, date 27.12.2023 njoftim detyrime banore te fshatit Klos-Katund,

-Me shkresën nr. 3453 prot, date 19.12.2023 njoftim detyrime banoreve te fshatit Patin,

-Me shkresën nr. 3503 prot, date 21.12.2023 njoftim detyrime banoreve te fshatit Fullqet,

-Me shkresën nr. 3453 prot, date 19.12.2023 njoftim detyrime banoreve te fshatit Bel.

Rekomandimi është në proces

2.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që për 4 subjektet “S. C. Shpk”, “A-D. Sh.P.K, dhe “F-2”, 5”, 5” M – O”, të paguajnë detyrimet ndaj Bashkisë Klos, me vlerë vjetore **1,041,592 lekë** l, ose në të kundërt të merren masa për ndërprerjen e autorizimeve.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos me shkresën nr. 3074 prot, date 13.11.2023 ka njoftuar subjektet që kanë hidrokarbure, janë bërë likuidimet pjesore në bazë të kontratave.*

Rekomandimi është në proces

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos të bashkëpunojë dhe të kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 797.11 ha, duke aplikuar tarifata dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit **(49,420,820 lekë për 21 subjekte).**

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos ka bërë evidentimin dhe ka dërguar njoftimet për lidhjen e kontratave me subjektet përkatëse.*

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

C. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; nenin 64 shkronjën g të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 11, kreun IV dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Klos fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore **(në proporcion me shkeljen e kryer)**, për punonjësit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në raportin përfundimtar të auditimit.

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos nuk ka marr asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimin konsiderohet i pazbatuar.

E. Për punonjësit e larguar.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1.z. I. H. me detyre ish/Kryetar për periudhën objekt auditimi.

2. z. A. Gj. me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Klos, për problemet e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në dy procedura.

3. Znj. F. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Ardhurave, për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të ardhurave në buxhetin e bashkisë;
-si dhe në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në dy procedura;

Konkluzion: Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 865/8 prot., datë 29.12.2023, ku janë lënë për zbatim 18 masa organizative, 3 masa të ardhura të munguara dhe 3 masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 18 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, 11 masa janë në proces zbatimi dhe 5 masa janë të pa zbatuara.

b. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 3masa në vlerën 63,396,341 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë në proces zbatimi 2 masa dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht.

c. Masa disiplinore janë rekomanduar 3 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë të pa zbatuara.

-Gjithashtu nga Bashkia Klos nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. V. K. në funksionin e Kryetares së Bashkisë Klos, zj. E. N. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Cështjeve Juridike dhe Shërbimeve Financiare, zj. H. M. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve, Licencave, Kujdesit Social, Ndhimës Ekonomike, Strehimit Social, Barazisë Gjinore dhe Drejtave të Njëriut, z. V. M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm.

2.5.Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Gjatë auditimit nuk pati probleme apo çështje të tjera për të shqyrtuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

“Mjedisin e kontrollit”.

- Bashkia Klos nuk ka një Kod Etike të mirëfilltë, të trupëzuar në një dokument të veçantë.

- Nuk është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për vitin 2023, për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm e për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese.

- Për periudhën 2023 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, i cili nuk ka kryer detyrat për vendosjen e rregullave të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

“Menaxhimi e Riskut”

Bashkia Klos nuk ka hartuar një strategji plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit dhe tolerancës së riskut, duke mos përcaktuar kështu nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

Titullari i Bashkisë Klos për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, si dhe nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të MFK si dhe plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8, pika 8, germa “b”, neni 27, pikat 1-2, neni 16, pika 2-3, neni 21, pika 2; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3; Rregullorja e Brendshme neni 16 “GMS”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Klos, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për: (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit; (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrit të Riskut; (iii) të hartohet Kodi i Etikës së institucionit dhe Rregullorja e Posaqme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; (iv) Të sigurojë raporte periodike mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm shoqëruar me një plan menaxhimi për veprime korigjuese; (v) të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit për çdo proces pune, të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e GMS dhe EMP, si dhe të dokumentohet puna e tyre

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2023 u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2023 është në vlerën 654,333 mijë lekë nga vlera 839,319 mijë lekë e planifikuar, ose në masën 78%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 72%, i cili tregon për planifikim me rezervë të tij, si dhe zëri 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 49%, duke krijuar detyrime e reja të prapambetura nga mos realizimi i të ardhurave dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur gjendje limitin e arkës në dispozicion.

b. Nga auditimi rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 88,691 mijë lekë, e përbërë nga vlera prej 77,545,251 lekë e faturave të papaguara me financim nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar e raportuar në MFE dhe vlera prej 11,146,662 lekë e faturave të pa likuiduara me financim nga Ministrinë

e linjës, për të cilat është ndërprerë alokimi i fondeve që nga viti 2013. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të pa paguara të Bashkisë Klos janë 77,545,251 lekë dhe përbëjnë 26.7 % të shpenzimeve faktike vjetore prej 290,243 mijë lekë me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta. Në këto kushte Bashkia Klos konsiderohet në “*vështirësi financiare*”, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura tejkalon nivelin prej 25% të shpenzimeve vjetore faktike. Nga Bashkia nuk janë marra masa të mjaftueshme për daljen nga kjo situatë.

c. Financimi i buxhetit vjetor 2023 është bërë në masën më të madhe prej 98.3% nga Buxheti i Shtetit (*transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike*) dhe 1.7% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësitë vendore nga burimet tjera.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52; Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 153-162, ligji nr. 68 datën 27.4.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” neni 40/h,42,55,56; Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*” pika 33, (Tabela 1) dhe pikat 86-123, Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, Kreu “*Detyrimet e prapambetura të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore*”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar neni 12 pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 25-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve, Licencave, Kujdesit Social, Ndihmës Ekonomike në bashkëpunim me grupin e menaxhimit strategjik të kryejë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, duke rritur bashkëpunimin me operatorët ekonomik për përfundimin dhe dorëzimin e punimeve në afat, sigurimin e mbërritjes së faturave në institucion dhe likuidimin e tyre.

2.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos të hartojë një plan specifik zbatimi për daljen nga gjendja e vështirësisë financiare duke ja paraqitur Këshillit bashkiak. Të marrë masat për rritjen e të ardhurave, shkurtimin e shpenzimeve dhe mundësitë potenciale të aseteve në dispozicion duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që këshilli bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës së vështirësive financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e gjendjes në vlerë historike prej 48,492,510 lekë llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” në mbyllje të vitit 2023, rezulton se vlera prej 31,683,734 lekë, që i përket 35 projekt-studimeve është e pa shpërndarë, sipas aktiveve përkatëse të investuara dhe të kapitalizuara në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël, por nuk ka inventar fizik. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu II pika16/b,d, Aneksi 1 pika 2 klasa 2, dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” Kreu III. pika 26, 27,30, Kreu IV. pika 73,74,78. **2.1.** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 42-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve, Licencave, Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike, në Bashkinë Klos të kryejë inventarin fizik projekteve të studim-projektiveve të blera gjendje e llog. 202 “Studime dhe Kërkime”, dhe të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre, si vlerë e shtuar sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar, duke i kryer veprimet sistemuere kontabël në llogaritë përkatëse.

Deri me datë 31.03.2025

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë në gjendjen e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **90,232,252 lekë** janë përfshirë 15 fatura të papaguara në vlerën 89,311,973 lekë të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit (60-ditë) të vitit ushtrimor të mbyllur, të cilat duhet të ishin pjesë e gjendjes e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasi klasifikohen si detyrime të prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III pika 3.1 nënpika 42, Aneksi I pika 3.3/c. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 42-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në kontabilizimin e faturave nga furnitorët për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh, të jetë e kujdesshme në klasifikimin e tyre, sipas afateve 60 ditore, duke i ndarë ato në detyrime të prapambetura dhe detyrime brenda afatit të likuidimit në thesar dhe duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të klasës 4 sipas këtij klasifikimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjithë procedurës së inventarizimit rezulton se, nuk ka përfunduar procedura e klasifikimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi në ato që mbetjet e tyre kanë akoma vlerë përdorimi dhe kthimi i tyre në magazinë si dhe ato mbetje që nuk kanë vlerë përdorimi e vazhdimi për asgjësimin e tyre. Gjithashtu nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJM të përfshira gjendje në llogaritë: 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Ndërsa në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë regjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet, kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes së tyre” pika 26, 27,30, Kreu IV, pika 73,74,78. 2.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 42-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Klos nëpërmjet Drejtoria Ekonomike e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve, Licencave, Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike, të marrë masa që:

- Të përfundojë procesin e inventarizimit dhe asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi dhe të kryejë dokumentimin e procesit, të shoqëruar me sistemimet kontabël në llogaritë përkatëse;

- Të rishikojë regjistrin e aktiveve të llogarive 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, të bëjë plotësimet e duhura në mënyrë që këto aktive të paraqiten në vlerën e plotë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të asetëve rezulton se janë **1209 pyje-kullota** të transferuara në fazë përfundimtare dhe **395 prona** të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Klos (Qendër) dhe 3 Njësi Administrative si Suç, Gurre dhe Xibër, që janë në fazën e miratimit të listave fillestare. Për këto prona nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit dhe nuk është kryer asnjë proces për transferimin e pronave nga faza fillestare, në atë paraprake dhe më pas në atë përfundimtare dhe miratimi i tyre me VKM e si rrjedhojë nuk është kryer asnjë proces hipotekimi/certifikimi. Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë. Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për për 4 Njësitë Administrative Klos, Suç, Gurre dhe Xibër, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuara, si dhe mos vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 56-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Klos nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 Njësi Administrative Klos (Qendër) Suç, Gurre dhe Xibër, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKM e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet. Më pas listat paraprake të pronave të miratuara të kalohen në fazën përfundimtare të transferimit të tyre në pronësi/përdorim Bashkisë Klos, të miratuar me VKM, duke hapur rrugë përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor për regjistrimin e tyre në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 208/10 Prot, datë 18.7.2023, rezulton se:

- Nga subjekti është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 865/8 prot., datë 29.12.2023, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”. Gjithashtu është respektuar dhe afat 6 mujorë në zbatim të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.
- Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, kemi si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **18 masa organizative** të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 11 masa janë në proces zbatimi, **1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 5 masa janë të pa zbatuara.**

b. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara) janë rekomanduar **3 masa në vlerën 63,396,341 lekë**, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë në proces zbatimi 2 masa dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht.

c. Masa disiplinore janë rekomanduar 3 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë të pa zbatuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 63-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkohet** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Masa Organizative.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të ndërpresë praktikën e krijimit të debitorëve dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit duke saktësuar veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke i evidentuar në librin e madh apo centralizator dhe në librin e veprimeve të ndryshme.

7.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosija dhe vlerësimi i çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Klos në bashkëpunim me komisionin e prokurimit për procedurat me vlera të vogla të marrë masa që në momentin e hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, që të shmangët mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Klos në bashkëpunim me sektorin e Financës të marrë masa që për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

10.1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla në çdo rast të argumentojë kryerjen e Procedurave të prokurimit sipas nevojës së sektorëve të ndryshëm të Bashkisë.

11.1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla të kryejë përlllogaritjen e fondit limit për të gjitha procedurat e prokurimit për të cilat nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për krijimin e një komisioni për përlllogaritjen e fondit limit.

12.1. Rekomandimi: Nga DPTSHIP Klos të merren masa për të kërkuar plotësimin e të gjitha kriterëve të nevojshme për hartimin e dokumentit të rilevimit topografik, për të gjitha ato raste që do të pajisen me leje ndërtimi / zhvillimi dhe plotësimin me dokumentacionin e plotë të çdo certifikatë përdorimi.

13.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Klos të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Nga Bashkia Klos të merren masa për shqyrtimin brenda afateve kohore të kërkesave për pajisje me leje ndërtimi.

-Nga Bashkia Klos të merren masa për respektimin e të gjitha kriterëve të përcaktuara, për rregullimin e veprimtarisë ndërtimore të subjekteve zhvilluese.

14.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Klos të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

15.1. Rekomandimi: Nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të merren masa për respektimin e të gjitha afateve kohore në lidhje me mbajtjen e procedurave përkundrejt kundërvajtësve, sipas përcaktimeve ligjore.

16.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkinë Klos të marrë masa dhe të ngrejë grupet e punës për të kryer inventarizimin e asteve sipas llojit të asetit dhe të marrë në dorëzim me procesverbale, përkatëse për çdo aset.

-Drejtoria e financës në bashkëpunim me drejtorinë e menaxhimit dhe aseteve, dhe Drejtorinë e Pyje/kullota, të marrin masa për marrjen e informacionit të sakta, për regjistrimin e pronave si dhe për të hapur regjistra kontabël për çdo aset që bashkia ka të inventarizuara.

18.1.Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Klos të vendosen marrëdhënie kontraktuale me operatorët ekonomikë, duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 797.11 ha, duke aplikuar tarifat të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (49,420,820 lekë për 21 subjekte).

B. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore:

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të paguar, Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

2.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që për 4 subjektet “S. C. Shpk”, “A-D shpk, dhe “F-2015”, “M-O”, të paguajnë detyrimet ndaj Bashkisë Klos me vlerë vjetore **1,041,592 lekë**, ose në të kundërt të merren masa për ndërprerjen e autorizimeve.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, për vitin 2023 nuk kanë paguar 26 individë me vlerë totale **661,021** lekë për 25 objekte të legalizuara, që përbën në të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Klos. Ndërsa për vitin 2022 kanë qenë debitorë 2 subjekte, të cilët kanë likuiduar detyrimin në vitin 2023, kurse para vitit 2022 nuk ka debitorë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së

mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, me VKB nr. nr. 79, datë 21.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Klos në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave Vendore, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 26 debitorë në vlerën **661,021 lekë**, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Klos për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, në territorin e Bashkisë Klos për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet për lejim ushtrim aktiviteti, për të cilat kanë kryer pagesa pjesore 3 subjekte dhe 1 subjekt nuk ka shlyer tarifën në vlerë të plotë, duke rezultuar me **detyrime të pashlyera në vlerë totale 2,200,000 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3, pika 15.1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga **4 subjektet në vlerën 2,200,000 lekë** përkatësisht:

- vlera **1,000,000** lekë nga subjekti “V” shpk.
- vlera **400,000** lekë nga subjekti “S” shpk.
- vlera **400,000** lekë nga subjekti “M. O” shpk.
- vlera **400,000** lekë nga subjekti “F.” shpk.

Brenda datës 31.12.2024

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET KONTRAKTORE NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos paraqitet në masën 68 %, nga 60,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 40,467 mijë lekë. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave rezultoi se:

- Taksapaguesit familjarë në bazë të paketës fiskale të miratuar me VKB ngarkohen taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe taksën e përkohshme të arsimit, por nuk ka të dhëna të sakta lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar dhe nivelin e pritshmërisë së tyre, si dhe numrin e familjeve debitore.
- Mungon informacioni i saktë dhe i plotë për familjet fermere, që kanë detyrimin të paguajnë taksën bujqësore, gjë e cila reflektohet në planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës në masën 37%. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit

të Bujqësisë dhe Pyjeve mungojnë të dhënat për familjet, që zotërojnë ATMP, por ka të dhëna për sipërfaqen e tokës së ndarë, e cila është 3880 ha. Për taksën e tokës është aplikuar tarifa e përcaktuar në paketën fiskale prej 1000 lekë/ha (kat.IV), të dhëna këto për bazën e planifikimit të të ardhurave në shumën 3,880,000 lekë dhe jo 1,500,000 lekë sa është planifikuar e ardhura në fakt. Bashkia Klos nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Vlera totale e detyrimit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën **71,553,467 lekë**, vlera e detyrimit të krijuar **gjatë vitit 2023 është 9,082,945 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën **80,636,412 lekë**, e cila është kontabilizuar në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe përbëhet nga:

- vlera 41,574,936 lekë për 274 subjekte, debitorë nga taksat dhe tarifave e biznesit të vogël dhe të madh;

- vlera 39,061,476 lekë për 2875 abonentë familjarë, debitorë nga taksat dhe tarifave;

Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për mbledhjen e borxhit tatimor në vitin 2023 është mjaftuar vetëm 129 njoftime për detyrime për debitorët e biznesit të madh dhe të vogël, si dhe njoftime për banorët e 9 fshatrave për shlyerje detyrimesh ndaj Ujësjellës-Kanalizime Klos, të shoqëruara me taksa-tarifave, por nuk ka janë aplikuar masa shtrënguese dhe masa të tjera, që parashikojnë dispozitat ligjore.

Këto veprime janë në kundërshtim me në kundërshtim me përcaktimet VKB-së nr. 79, datë 21.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Klos për vitin 2023, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publik, Lejeve dhe Licencave të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **80,636,412 lekë** nga debitorët e privat dhe familjarë.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Klos në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur 24 kontrata përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për dhënie me qira të aseteve, që ka në pronësi apo në përdorim për afate kohore nga 1-30 vjet, të cilat janë të pa noterizuara. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor, për pemëtari, antena, shtrirje linjash, tubacione e ndërtesë për Hec, ndërtim fabrike pasurimi, studim-kërkim-zbulim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi, agroturizëm fotovoltaike etj.

- Nga verifikimi i dokumentacioni e dosjeve të kontratave dhe pagesave të kryera rezulton se, në fund të vitit 2023 paraqiten 8 subjekte qiramarrës, me objekt aktiviteti: 1 rast me agroturizëm, 3 raste antene, 3 raste Hec, 1 rast fabrikë pasurimi, me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën **2,219,127 lekë**.

- Në 5 raste kontratash për dhënie me qira, referuar nenit 3 “afati i kontratës”, nenit 4 “Vlera e kontratës” dhe nenit 5 “pagesa edhe rregjimi saj” është përcaktuar se: “Kjo kontratë i fillon efektet ligjore dhe financiare në momentin e paisjes së subjektit me lejen e ndërtimit nga qiramarrësi ...”. Në këto raste pavarësisht se nuk është marrë leja e ndërtimit (në AZHT)

nga këto shoqëri për objektin e kryesor të kontratës, parcelat e marra me qira nga fondi pyjor-kullosor kanë vazhduar ti mbajnë të bllokuara mbi 1 vit, duke mos lejuar Bashkinë ti ketë në dispozicion për vënie në shfrytëzim nga qiramarrës të tjerë, - Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe dokumentacionit të aseteve, rezulton se në territorin e Bashkisë Klos ushtrojnë aktivitetin 29 subjekte private, me aktivitet për prodhim dhe nxjerrje krom dhe gur gëlqeror në harkun kohor nga 1999-2023, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Klos. Nga Bashkia Klos, pavarësisht se janë dërguar njoftime në 21 raste shoqërive, nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim me rrjetin rrugor, shtrirje linjash e tubacione, vend-depozitim minerali apo sipërfaqe për ngritje ngrehinash etj., duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Klos.

Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 56-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e tarifës së qirasë nga 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në 2,219,127 lekë (sipas tabelës të paraqitur faqet 59-60 të Raportit të Auditimit). Ndërsa për 5 kontratat e bllokuara të qiradhënies për mos paisje me leje ndërtimi, të rishikohen dhe të merren masa që të vihen në efikasitet, në rast të kundërt të ndiqen procedurat ligjore për veprimet me to.

2.2. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkinë Klos në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Pyjeve dhe Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pa zbritura nga fondi pyjor, t’i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjorë”, i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë.

2.3. Rekomandimi: Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Pyjeve dhe Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojnë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë Bashkisë dhe Inspektoriatin Mbrojtjes Territoriale (IMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e saj të përdorin sipërfaqe pyjore/kullosore pa kontratë me bashkisë. Të gjitha kontratat e qirave duhet të jenë të noterizuar, ku si përfaqësues i Bashkisë duhet të jetë Kryetari i saj si nëpunës autorizues.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, **libet**

në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Klos, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT